

Rruga e Arbërit



Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti II i Botimit. Nr. 3(11). Mars 2007 Çmimi: 30 lekë

Dibra në rrugën e dijes

Nga XHEMAL DOMI

Në gojën e popullit dëgjo het shpesh shprehja: "Mendja lindi në Shkodër, hëngri drekë në Mirditë dhe fjeti në Dibër". Mjafton pjesa e fundit "fjeti në Dibër", për të përcaktuar se kush është Dibra dhe kush janë dibranët. Kultura origjinale, shkolla e Dibrës, e trashëguar dhe e përpunuar në shekuj në rrjedhën e historisë, që nga etnosi ilir deri në ditët tona, përbën një nga trashëgimitë më të vlefshme të qytetërimit të popullit tonë.

Rilindësit tanë si N. Veqilharxhi, Z. Jubani, K. Kristoforidhi, A. Frashëri, Hoxha Tahsini, P. Vasa, S. Frashëri, A. Kulluristi, J. Vreto, K. Hoxhi, N. Frashëri, Petro N. Luarasi, vëllezërit e motrat Qiriazzi, I. Qemali, Babë D. Karbunara, F. Noli, L. Gurakuqi, H. Prishtina, Sali Ceka, Dervish Hima, Said Najdeni, Josif Bageri, Ibrahim Temo, Hamdi Ohri etj., hodhën bazat e mendimit pedagogjik shqiptar, duke përcaktuar rrugët për zgjimin dhe rritjen e një populli të shtypur dhe të nëpërkëmbur, siç ishte populli ynë në ato kohë të vështira, por edhe të lavdishme. Ata përpiluan alfabetet, shkruan libra, që nga abetarja e Veqilharxhit deri te pamfletit politik i Sami Frashërit "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është, e ç'do të bëhet" etj., me të cilat ngritën peshë ndërgjegjen kombëtare dhe hodhën bazat e shkollës shqipe.

Shkolla e parë shqipe dihet se u hap në Korçë më 7 mars 1887, 120 vjet më parë. Por nuk duhet harruar se në shkollat fetare, kullat dhe kasollet shqiptare, si në gjithë Shqipërinë edhe në Dibër mësohej fshehurazi shqipja me alfabet latin në fshatra e qytete. Shkrimi dhe shkolla shqipe do të ishin mjet i fuqishëm për të forcuar ndërgjegjen kombëtare edhe te dibranët.

(Vijon në faqen 5)

RRUGA E ARBËRIT i mungon Shqipërisë

Nga Msc.Ing.Agim SHENJATARI
FAQE 3-4




Pamje nga kalaja e Petralbës, rrëzë së cilës kalon Rruga e Arbërit

Intervistë me prof. Hajri Shehun, punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë

Po punojmë për "Fjalorin me fjalë e shprehje të Ujemujes"

FAQE 6-7



VISARE NGA ODA DIBRANE

Ditë vjeshte në konakun e Mete Skepit

Nga NAIM PLAKU

Atë mëngjez, sa dielli kishte qit shtat në shpatullën e djathtë të Korabit, Mete Skepi u lëshoi fap e fap nja dy grushte ujë syve, hodhi kinin e kuq në sup, dhe, siç bënte zakonisht, hapi derën e kullës, lidhi qenin në hatulla e doli në lëndinën e lagur me lashtën e butë të asaj vjeshte. ...
FAQE 12

Rreth kodit artistik të dasmës dibrane



Nga Prof. Dr. SHABAN SINANI
FAQE 10

NË BRENDESI

KONGRESI I DIBRËS

NGA SHERIF DELVINA
FAQE 8

"Mjeshtër i epikës dhe lirikës kombëtare"

FAQE 12

"Një iluminist i etur për dituri"

FAQE 11

Bulqizë, hapet drita jeshile për minierën

FAQE 2

Homazhe mbi varrin e Said Najdenit

FAQE 2

Mungesa e medikamenteve favorizon gripin

FAQE 8

Tregu në rrugë, konsumatorët të pambrojtur

FAQE 9

NGUSHËLLIM

Kryesia e Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" dhe redaksia e gazetës "Rruga e Arbërit" ngushëllojnë z. Rakip Suli për vdekjen e xhaxhait të tij, Haxhiut.

Hapet drita jeshile, për minierën e Bulqizës

Darfo u jep dy firmave ruse "Deka Metal" dhe ajo austriake "ICF"

Më në fund, duket se ësh të hapur drita jeshile, për vënie në eficientë, të minierës më të madhe të nxjerrjes së kromit në vendin tonë dhe më gjerë, asaj të Bulqizës. Këto ditë, në qytetin e Bulqizës, kanë ardhur për t'u interesuar për këtë minierë, specialistë të dy firmave ruso-austriake. Janë pikërisht firma ruse "Deka Metal" dhe ajo austriake "ICF", të cilat kanë zbritur në Bulqizë dhe po investojnë, për privatizimin e ri me konçension të kësaj miniere. Kjo minierë, që në 59 vjet jetë të saj, ka dhënë për vendin mbi 12 milionë tonë krom, ku para viteve '90, interesi i pushtetarëve të kohës, për këtë minierë ishte jash-tëzakonisht i madh, pasi siç dhe deklarohet prej tyre, ishte prodhimi i kësaj miniere, që "çante bllokadën", duke realizuar 46% të të ardhurave kombëtare bruto. Në përbërje të kësaj industrie të nxjerrjes dhe pasurimit të arit të zi (kromit), funksiononin 4 ndërmarrje si; ndërmarrja gjeologjike që siguronte rezervat, ndërtim-miniera që bënte parapërgatitjen për shfrytëzim, miniera e nxjerrjes së kromit dhe fabrika e pasurimit që përpunonte kromet e varfra, me një fuqi punëtore prej rreth 12 mijë minatorësh. Pas viteve '90, duke pasur

parasysh potencialin e madh nxjerrës dhe cilësor të kromit, të këtij vendburimi, u afruan shumë firma të huaja, për ta marrë atë në shfrytëzim me konçension për një periudhë të gjatë kohore. Kështu në 2001, kjo minierë u privatizua me konçension për 30 vjet, nga firma italiane "Darfo-Albania". Por duhet thënë se që në fillimet e tij, ky privatizim rezultoi i pasuksesshëm, pasi firma konçensionare në vazhdimësi shkeli kontratën, duke mos bërë asnjë lloj investimi, në këtë minierë. Numri i punëtorëve, ra në mënyrë drastike, ku aktualisht punojnë vetëm 600 minatorë, duke marrë një pagë të vogël, prej rreth 20 mijë lekësh në muaj dhe pa asnjë lloj trajtimi për ta. Jo vetëm kaq, por "Darfo-Albania", nuk ka shlyer asnjë lek taksë vendore për bashkinë e qytetit. Kështu besueshmëria dhe pakënaqësia e minatorëve, ndaj kësaj firme, erdhi në rritje të vazhdueshme, deri në protesta të fuqishme, që kulmuan me bllokimin e rrugës nacionale Tiranë-Peshkopi, në korrik të 2002. Edhe pse në mbarë opinionin e trevës së Bulqizës dhe më gjerë, firma konçensionare "Darfo-Albania", prej kohësh u pa se ishte një firmë fantazmë dhe e dështuar.



Bulqiza

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: RAKIP SULI

Kryeredaktor: SHAQIR SKARRA

Redaksia: Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Prof. Dr. Shaban Sinani, Bujar Karoshi, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala

ADRESA E GAZETËS: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë. Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.

Email: lid_gazeta@yahoo.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e Redaksisë dhe Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë".

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" ka dhe numrin e saj të llogarisë në PROCREDIT BANK
Në lek 13-661344-0001 . Euro 13-661344-0102 . USD 13-661344-0203

KRONIKË NGA DIBRA E MADHE



U festua Dita e Mësuesit dhe 120-vjetori i Shkollës së Parë Shqipe

Homazhe mbi varrin e iluministit Said Najdeni

Arsimtarë, veteranë të arsimit, arsimdashës dhe udhëheqës të pushtetit vendor, me rastin e 7-marsit u bënë homazhe dhe u vendosën lule mbi varrin e iluministit dibran dhe mbarëkombëtar Said Najdeni. Pëllumb Frangu, drejtor i SHF "Said Najdeni", me këtë rast, tha se Said Najdeni si dhe rilindësit e tjerë me veprën e tij ishte shembull se si duhet të zhvillohet arsimiti shqip, të luftohet injoranca, vëllavrasja dhe veset që nuk i takojnë shqiptarit. Më pas në Qendrën Kulturorë u hap ekspozita me punime vizatimesh me tema të larmishme nga nxënësit e shkollave fillore "Vël-lazërim Bashkim" dhe "Said Najdeni". Pas kësaj në sallën e madhe u mbajt akademi solemne ku merrnin pjesë edhe profesorë dibranë nga prishtina, Tetova, Ilir Kroshi, kryetari i Bash-

kisë së Peshkopisë me stafin e tij, mr. Ruzhdi Lata, myftiu i Dibrës, Gëzim Ostreni etj. Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës, duke përshëndetur të pranishmit, theksoi angazhimin e pushtetit aktual vendor në krijimin e kushtetve më të mira për nxënësit e shollava në Dibër dhe për domosdoshmërinë e ndërtimit të godinës së re të gjimnazit. Prof. Dr. Mahmud Hysa u paraqit me kumtesën e tij shkencore me titull "Rruga e gjatë, e vështirë por e lavdishme", kushtuar 120 vjetorit të shkollës së parë shqipe, duke shtuar se, 7 marsi është një ditë e lavdishme e tërë atyre që e ndërtuan historinë e shkollës shqipe dhe drejtuan kombin të hapërojë drejt horizonteve të reja dhe drejt popujve të zhvilluar, duke dërtuar njeriun që e do diturinë, që e

çmon lirinë dhe që sakrifikon për atdheun. Kjo ditë na sjell ndërmend, tha ai, tërë ata patriotë dhe intelektualë të mëdhën të kombit shqiptar të cilët sakrifikan dhe kontribuan në historinë e arsimit kombëtar. Duke folur për historikun e mësimit të gjuhës shqipe, ai vazhdoi, se mësimi i gjuhës shqipe ka ekzistuar edhe para hapjes zyrtarisht të shkollës së parë shqipe më 7 mars 1887 në Korçë dhe pas kësaj u hapën shkolla në Pogradec, Ohër, Dibër, Elbasan, Leskovik etj. Pas kësaj sopranoja e shquar dibrane Dëshira Ahmeti mahnti publikun me reperitorin e saj të një niveli të lartë artistik. Ndërkaq nxënësit e gjimnazit u paraqitën me një recital të bukur tematik kushtuar historisë së arsimit shqip.
Rexhep Torte

Nderohen katër dibranët emigrantë

Këshilli i Komunës në Dibër të Madhe ka mbajtur shtetancë të jashtëzakonshme komemorativë në fillim të muajit, në të cilën morën pjesë familjarë të personave që humbën jetën, këshilltarë, Argëtim Fida, kryetari i komunës dhe Ruzhdi Lata myftiu i Dibrës. Në praninë e mijëra qytetarëve dhe me nderime të mëdha në Dibër janë varrosur Petrit Bomova dhe Ramazan Trebishta. Dy të vdekurit e tjerë janë Linda Karameti 29 vjeçe dhe foshnja e saj En-gjëll Karameti 18 muajshe, janë varrosur në SHBA. Nizamedin Papraniku, kryesuesi i Këshillit të Komunës, duke ngushëlluar prindërit e viktimitave në emër të qytetarëve, propozoi një ditë zie për Dibrën dhe dibranët. Argëtim Fida, kryetar i Komunës së Dibrës theksoi se ky qytet, këtyre ditëve ka qenë i veshur me pikëllim, trishtim dhe revoltë nga rasti në fjalë. Fida, më tutje shtoi se kjo tragjedi tronditi shpirtat e tërë dibranëve kudo që ndodhen. "Shprehim njëherësh edhe revoltën tonë duke ngritur zërin kundër lënies pas dore të Di-

brës me dekada nga pushteti qëndror, që e detyron rininë tonë që perspektivën ta sheh te mërgimi", tha Fida. Ai tha se mërgimin e shtojnë edhe problemet e sigurisë në qytet, të cilat riciklohen me porosi nga ndonjë kuzhinë dashakeqe. Ai tha se dëshiron që sakrificat e këtyre të rinjve të shëndrohet në solidaritet me familjet e tyre dhe në bashkimin e forcave intelektuale dhe financiare këtu dhe në diasporë, duke nxitur Qeverinë e maqedonisë dhe faktorin ndërkombëtar të ndihmojnë në krijimin e kushteve që rinia dibrane ardhmërinë ta shohë në këtë qytet e jo në vendet e huaja

brës me dekada nga pushteti qëndror, që e detyron rininë tonë që perspektivën ta sheh te mërgimi", tha Fida. Ai tha se mërgimin e shtojnë edhe problemet e sigurisë në qytet, të cilat riciklohen me porosi nga ndonjë kuzhinë dashakeqe. Ai tha se dëshiron që sakrificat e këtyre të rinjve të shëndrohet në solidaritet me familjet e tyre dhe në bashkimin e forcave intelektuale dhe financiare këtu dhe në diasporë, duke nxitur Qeverinë e maqedonisë dhe faktorin ndërkombëtar të ndihmojnë në krijimin e kushteve që rinia dibrane ardhmërinë ta shohë në këtë qytet e jo në vendet e huaja. Ruzhdi Lata, myftiu i Dibrës, u shpreh se në këto raste kur dhimbjet vijnë nga jashtë edhe ngushëllimi është i

vështirë. "Profeti Muhamed thotë se vdekja është mësim, ndaj dhe ne duhet ta lexojmë, kuptojmë dhe aqarojmë, për të gjetur forca për të kapërcyer dhembjen, sepse ka ardhur çasti i fundit që çështja dibrane të shtrohet në tryezën e Qeverisë së Maqedonisë, të partive politike dhe të institucioneve tjera, sepse më se tri dekada në Dibër nuk është investuar në asnjë objekt ekonomik", tha Lata. Dibra është qyteti më karakteristik dhe unikal në botë, me mijëra dibranë të mërguar fillimisht në Turqi, 50 mijë dibranë që sot jetojnë në Itali, ndërsa 15 mijë në SHBA.
Rexhep Torte, 07.03.2007

(Marrë nga www.dibra.org.mk)

NJOFTIM

Gazeta "Rruga e Arbërit", njofton të gjithë lexuesit dhe bashkëpunëtorët, se numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit. Për abonimet dhe shpërndarjen e gazetës në adresën tuaj, duhet të telefononi në numrin e telefonit: (04) 357 179 ose të na shkruani në E-mail: lid_gazeta@yahoo.com

Rruga e Arbërit – shpresë apo realitet



Nga
Msc. Ing. Agim
SHENJATARI

Në lindje të Tiranës është e njohur prej dekadash Rruga e Dibrës, ashtu si shumë rrugë të tjera që lidhin Kryeqytetin me Durrësin, Elbasanin, Kavajën etj. Por duhet theksuar se kjo rrugë ka ekzistuar para se Tirana të caktohej kryeqytet në vitin 1920 dhe shumë më përpara se dibranët të vendoseshin në anë të saj në kohën e luftërave ballkanike, gjithashtu shumë më përpara se Tirana të themelohej si qytet. Ky arter i rëndësishëm rrugor pararomak lidhte detin dhe përtejdetin me lindjen europiane nëpër kanionet natyrale që natyra ka krijuar para dhjetëra e qindra milion vjetësh, në aksin më të shkurtër të mundshëm. Për rëndësinë e madhe të kësaj rruge në zhvillimin e tregtisë flasin dy marrëveshje të vjetra: E para në fillim të shekullit të XIII, ku Dhimitri "Princi i madh i Arbërit" u garanton raguzianëve "kalim të lirë në tokat e tij", pra nëpër shtetin e Arbërit dhe e dyta, është e vitit 1429, firmosur nga Gjon Kastrioti dhe bijtë e tij, me të cilën u sigurohej gjithashtu tregtarëve raguzianë "kalim i lirë nëpër tokat e Kastriotëve", pra nëpër luginën e Matit e më tej. Qafa e Murrizës, e vendosur në jug-perëndim të luginës së Matit në kufi me Zall Dajtin, përbënte pikën kyçe të lidhjes së ultësirës perëndimore pranëadriatike me pjesën lindore e verilindore të vendit. Nga qafa e Murrizës kalonin dy rrugë:

Qafë Murrizë – Guri i Bardhë – Ura e Vashës – Plani i Bardhë – Qafë Buall – Bulqizë Shkup.

Qafë Murrizë – Qafë Shkallë – Klos. Në Klos kemi ndarjen në tre drejtime:

Klos (Dars) – Ura e Halilit – Bel Unjatë – Gurrë (Krahu perëndimor i luginës së Matit).

Klos – Suç – Shoshaj – Urakë – Perlat Shkodër.

Klos – Bejnë – Cërujë – Patin, me dy variante. Varianti veror: Patin – Qafë Dardhë – Qafë Mesi – Qafë Murrë – Peshkopi dhe varianti dimëror: Patin – Kurdari – Gjalish – Lis – Qafë Murrë ... Kukës – Prizren.

Këto variante mbi dymijë vjeçare, të shoqëruara me ura, kala, karakolle, kalldrëme, që ruhen pjesërisht deri në ditët e sotme, pësuan deformime të thella në strukturë në shekullin e njëzetë. Kështu, në vitet '30 të shekullit të kaluar u hap rruga: Krujë – Qafështamë – Burrel – Lis – Qafë Murrë dhe rruga: Rrëshen – Ura e Matit – Klos që për fat të keq funksionuan shumë pak dhe sot shërbejnë vetëm për nevojat lokale. Gjatë Luftës së Dytë Botërore u punua për hapjen e rrugës Klos – miniera e kromit Bulqizë, kryesisht për qëllime të transportit të mineralit të kromit. Pavarësisht këtyre arterieve rrugore, rruga e Arbërit funksiononte, karvanët tregtare vazhdonin odisenë e tyre tradicionale nëpër portën e Qafë Murrizës. Në fillim të viteve '50 në funksion të ndërtimit të hidrocentraleve të Ulzës dhe Shkopetit u hap Rruga e Dritës, një nyjë e rëndësishme kombëtare, por me një kosto relativisht të lartë për ekonominë e vendit për sot dhe për të ardhmen. Rruga e Dritës i dha goditjen kryesore rrugës së Arbërit, rrugës Burrel – Qafështamë – Krujë, rrugës Burrel – Lis – Qafë Murrë e më tej. Theksojmë kosto të lartë ekonomike, sepse **devijimi** nga aksi tradicional mbi dymijë vjeçar (Klos-Tiranë) me gjatësi 40 km nuk është pak, por dy deri në tre fish i gjatësisë (Klos-

Milot-Tiranë) 110 km, gjë që vlen njësoj dhe për rajonet e Bulqizës, Martaneshit, Dibrës e më në lindje, deri në Gostivar, Tetovë, Shkup e më tej.

RRUGA E ARBËRIT DHE RESURSET NATYRORE

Natyrisht, kjo rrugë në shekuj nuk ka shërbyer vetëm për transport udhëtarësh, por veçanërisht për transport mallrash. Janë të njohura në shekuj pazaret e Klosit dhe të Lisit që ishin në aks të Rrugës së Arbërit. Në këto pazare tregtarët matjanë, dibranë, krotanë, tiranas dhe elbasanas shkëmbejnë mallrat industriale dhe blinin prodhime bujqësore e blegtorale, traditë që vazhdon deri në ditët e sotme. Duhet theksuar se në vitet '30 e në vazhdim, në pazarin e Urës (Klos) dhe në fshatrat përreth, tregtarët vendas dhe nga rrethet fqinjë kryesisht Kruja dhe Tirana patën ngritur dyqane mjaft funksionale në shkëmbimin dhe tregtimin e prodhimeve bujqësore, blegtorale e industriale, që i shërbenin ekonomisë vendase, por dhe tregut të Tiranës, Krujës, Elbasanit etj.

Me zhvillimin e ekonomisë së vendit, veçanërisht pas viteve '50, në Mat morën zhvillim të vullshëm investimet në industrinë e kromit, energjetike, mekanikën bujqësore etj.



Pamje nga kalaja e Xibrit. (Përballë fshati Shkallë)

Nga Mati dhe Dibra janë prodhuar dhe transportuar për në portin Durrësit mbi 20 milionë ton krom, me dhjetëra milionë m³ lëndë drusore, mermerë e gëlqerorë të mermerizuar etj., të cilët kanë të faturuar në koston e tyre për çdo ton dhe m³ dhe taksën e rëndë të transportit, që për fat të keq vazhdon të merret dhe në ditët e sotme nga djersa dhe munda i banorëve të këtyre trevave. Krahinat e Matit, Bulqizës dhe Martaneshit e më tej, janë të njohura për pasuritë e mëdha industriale që zotërojnë. Kështu, përlogariten në disa dhjetëra milionë ton rezervat prognoze në oksid kromi (Cr₂O₃), në disa dhjetëra milionë m³ rezervat në mermerë e gëlqerorë të mermerizuar, gëlqerorë pllakore, argjila industriale e materiale ndërtimi, bimë industriale e medicinale



Pamje nga kalaja e Xibrit



Pamje nga pjesa jugore e luginës së Matit

le, me rëndësi të madhe ekonomike për të sotmen e të ardhmen e këtyre trevave. Duhet theksuar se 90% e pasurive që përmendëm ndodhën në skajin jugor dhe lindor të luginës së Matit, vetëm 10-20 km nga porta e qafë Murrizës dhe vetëm 40-60 km nga metropoli Tiranë-Durrës.

Vendburimet kryesore të kromit ndodhen në Shkallë–Qafë Burreli-Manazdre, Bulqizë, Batër-Lugu i Gjatë-Thekën (Martanesh), por dhe rezervat gjeologjike prognoze të përlogaritura nga specialistët e fushës, ndodhen afër dhe përreth këtyre vendburimeve të njohura. Gëlqerorët e mermerizuar të tria-

kalimtar i rëndomtë, sqimatar, strateg ushtarak, alpinist, studiues, poet apo shkrimtar etj., besoj, duke qenë njëri prej tyre, se në kujtesën e gjithësecilit kanë mbetur mbresa të pashlyeshme nga koha, që nuk kanë të krahasuar me gjë tjetër. Por, i dashuri lexues i gazetës "Rruga e Arbërit", ato që e kanë pasur këtë kënaqësi, ata që e njohin këtë të vërtetë, këtë vlerë të papërsëritshme, janë së pari; banorët e këtyre trevave me njohje të pjesshme, të shkëputur e ndarë keqas nga njëri-tjetri, së dyti, fatkeqët e kohës së diktaturës, mësues, mjekë, inxhinierë, agronomë, ushtarakë etj., që punuan e shërbyen për vite në këto anë, që kanë si pronë vetëm kujtimet e një pjese të rinisë së tyre dhe vetëm kaq, sepse, i dashur lexues, edhe ato që patën mundësinë të integrohen në sferat politikëbërëse e vendimmarrëse të vendit, qeveri, parlament, pushtet lokal etj., nuk organizohen në lobe përfaqësimi interesash, si kudo në botë, për të zgjuar nga gjumi shtetin, që ka gati një shekull që nga 1912 që fle e nuk e di se ç'bën e ç'duhet bërë.

ÇFARË I BËN INTERESANTE KËTO RAJONE?

Peizazhet e rralla e karakteristike të malit me Gropa dhe malit të Micekut, ku takohen gropa natyrale me diametër deri në 50 m e me thellësi deri në 15-25 m me ponore në konuset e tyre fundore që mbajnë borë deri në fillimet e të nxehtëtit të verës. Diversiteti gjeologjiko-gjeografik, ku, krahas formave të sipër-përmendura të relievit, takohen ultësira natyrale si ajo e Bizës, Ballesë, luginat si ajo e Valit, kanione si ai i Tujanit, urës së Vashës, Blishtes etj., maja malesh me pllaja si ajo e Kaptinës, qafa karakteristike si ajo e malit të Zi, liqene malore karakteristike si liqeni i Zi, liqeni i Sopeve, liqeni i Bardhë në Martanesh, liqeni i Dhive në Balgjaj etj. Biodiversitet mjaft interesant, ku theksojmë kullotat tipike alpine me barin e tyre karakteristike, bimët e shumta mjekësore e aromatike që rriten në luginat, shpate dhe kreshta, pyjet e rralla të pishës, bredhit të Martaneshit që përbëjnë kritere për ligjërimin e një parku kombëtar të mbrojtur nga dëmtimi i mëtejshëm. Një tjetër vlerë e këtij rajoni janë resurset minerale, historia zhvillimit të tyre, vlerat historike të zonës, bujaria dhe fisnikëria e njerëzve që jetojnë në këto treva, që këtu e 100 vjet më parë e detyruan Isuf Myzyrin të krijonte këngën e famshme deri në ditët tona "Ma mirë në pyll sesa në qytet", aq më tepër me këto qytetet tona, të ditëve të sotme, të mbytura nga pluhuri dhe smogu. Po ta pyesësh një tiranes, durrsak apo elbasanli se në ç'vënd ke qenë, mund të të përmendë vende europiane, aziatike, plazhe ekzotike e ku di unë se çfarë, por mos prit të të thotë se ka qenë në malin me Gropa, te liqenjtë malore të Martaneshit, të Balgjajt. E përse? Sepse mungon infrastruktura rrugore, mungon interesi shtetëror për investime në këto sektorë prioritarë me mjaft interes për turizmin malor, vetëm 20 apo 30 km në lindje të metropolit një milionësh Tiranë-Durrës.

(Vijon në faqen 4)

GJEODIVERSITETI DHE BIODIVERSITETI

Për atë që i ka rënë rruga të kalojë malin e Dajtit në pranverë, verë, vjeshtë apo dimër, që të ndalet vetëm për pak kohë në peizazhin e malit me Gropa, në ultësirën e Bizës dhe Ballesë, në pllajën e malit të Kaptinës së Martaneshit, në luginën e Linosit, në Malin e Zi (të Xibër Murrizës), në Gurë të Bardhë, në livadhet e Micekut, luginën interesante e mbresëlënëse të Valit të Martaneshit, liqenet malorë, shpellat karstike etj, qoftë dhe për pak kohë si

Rruga e Arbërit – Shpresë apo Realitet

(Vijon nga faqja 3)

MIKROKLIMA

Rajoni i Matit dhe Martaneshit kanë karakteristika të ndryshme klimatike e mjedisore, gjë që ka kushtëzuar dhe zhvillimin e orientuar lokal të tyre. Kështu, krahina e Martaneshit, Macukullit e Zallë Gjoçajve, me një mikroklimë të ashpër, në shekuj kanë qenë shquar për mbarështrimin e bagëtive të imta, kryesisht dhen dhe dhi. Vetë pozicioni gjeografik me klimë të ftohtë dhe të freskët, me verë relativisht të shkurtër dhe dimër të gjatë nuk favorizonte të mbjellat bujqësore, pemëtarinë e vitikulturën. Nga ana tjetër lugina e Matit karakterizohet nga një mikroklimë e nxehtë dhe e thatë në verë, ndërsa e lagësht dhe e butë në dimër. Një mikroklimë e tillë në shekuj ka favorizuar rritjen, kultivimin e pemëtarisë, veçanërisht të vreshtarisë. Matjani në shekuj nuk mund ta konceptonte shtëpinë dhe arën e tij të parrethuar me lloj-lloj pemësh frutore e varietete rrushi, deri në kultivarët lokalë me emër në prodhimin e rakisë, verës, mushtit, hardallisë si: rrushi i "Cërullës", "Gjalishit", "Tajga" etj. Aq favorizuese është mikroklima në këtë rajon për rrushin, sa, kronikani i Perandorisë Osmane Elvia Çelebi, kur e kaloi nga qafa e Thanës (mali i Bejnës), nëpër Shëngjun, Bejne, Fullqet, Gurra, Frankth për në qafë Shtamë e Krujë thekson "... ishte korrik, por nuk pashë diell me sy nga tendat e rrushit..." Përmendet dhe një fakt tjetër interesant për sa i përket prodhimit të rrushit në këtë zonë, po në periudhën e sundimit osman, ku në vitin 1467, në taksat për vreshtarinë, kazaja e Matit paguante rreth 300 000 litra lëng rrushi në vit pa llogaritur atë çfarë ato konsumonin për vetë ku vera në kohën e Skënderbeut dhe lëngu i rrushit (mushti, hardallia) pas islamizimit masiv piheshin në vend të ujit.

Në ditët e sotme, në kushtet e ekonomisë së tregut, matjani i është kthyer traditës që në një farë mënyre u deformua në vitet e kolektivizimit ku punohej për gjithçka e për shumëçka. Ka filluar e vazhdon me intensitet mbjellja e pemëve frutore, rrushit e krahas tyre mbajtja në një numër më të vogël të bagëtive. Vlen të theksohet se mbështetja me mikrokredi nga shteti mungon fare. Produktet e prodhuara, megjithëse cilësore nuk kanë infrastrukturën e nevojshme të përpunimit në rrugë industriale si baxho, punishte rakisë dhe verë, fabrikë përpunimi mishi, fabrikë përpunim bimësh industriale etj. Natyrisht, matjani sot prodhon mish cilësor, por e konkurren në mënyrë të pandershme mishi maqedonas, prodhohet në rrugë artizanale por me cilësi, si qëmoti rakia dhe vera e famshme e Klosit, por konkurren në mënyrë të pandershme nga "grapa" dhe verërat alkoolike të ngjyrosura bukur me reagente kimikë, nga kushedi se ku, e kushedi se ku. Prodhohet qumësht cilësor dhe, deleje, lopë me bazë bare e lule mali, por nuk shitet ose shitet nën kosto. Mblidhen më shumë mund e sakrificat bime industriale e medicinale aq të njohura në Mat, por u shiten matrapazëve të pandershëm vendas e të huaj për një copë



Pamje nga kalaja e Petralbës

bukë. Ishte për të të ardhur keq, kur vite më parë takova rastësisht një bari në malet e Skënderbeut, i cili kishte me leverdi ta derdhte qumështin apo t'ua jepte kecase, sesa ta shiste me atë çmim qesharak që nuk i nxirrte as shpenzimet e udhëtimit dhe nuk bëhej fjalë për pak, por për 100-120 litra qumësht në ditë që ai merrte bashkë me ortakët, në tufën e tij. A mundet shteti ynë, shtetarët tanë, politikëbërësit qendrorë dhe lokalë të hartojnë dhe të mbështesin politika ekonomike të diferencuara, të mbështetura me mikrokredi në drejtime prioritare dhe me interes në zhvillimin ekonomik lokal. Dihet se në botë, por dhe rreth nesh, ka krahina të njohura për prodhim të orientuar si p.sh. krahina e Shampanjës në Francë e njohur për prodhimin e verërave, rajonet e Napolit në Itali, të njohur në botë për prodhimin domates për salcë, rajone të tjerë të njohur për prodhimin e djathërave, proshutës etj. Po në vendin tonë a ka mundësi të tilla? Ka. Por nuk dihet se kur do të mendohet e punohet për to.

Në televizionin shqiptar, por dhe në televizione të tjerë kombëtare që mbahen në këmbë me taksat të taksapagueseve shqiptarë, përveç emisionit "Hapësirë e Gjelbërt", që tek-tuk në një hapësirë të kufizuar, trajton probleme të zhvillimit të prodhimit bujqësor e blegtoral as një kronikë problematike shqetësuese nuk zë vend, nuk sjell shqetësimet e prodhuesit lokal, tregut të munguar, infrastrukturës mizerabël të përpunimit të prodhimeve blegtorale e bujqësore. Është për të ardhur keq që vendin e parë në TV tona e zë kronika e zezë, sharjet politike shumëplanëshe, sikur në kemi lindur vetëm për t'u rrahur, sharrë apo vrrarë. Vërehet mungesa e theksuar e mendimit të opinionit publik, vërehet mungesa e opinionistëve të spektrit profesional, me bagazh dhe përvojë shumëvjeçare. Për fat të keq opinionin i publikut nuk është ai që merret në kronikat e ndërtuara në bulevardet e Tiranës, por tek prodhuesi i thjeshtë që i bie bretku në arë, që me një ofshamë shpreh njëmijë fjalë që s'kanë nevojë për koment. **"Një popull që s'ka opinion publik, nuk mund të numërohet për komb"**, - ka thënë ideologu ynë i rilindjes **Sami FRASHËRI**. Me gazetare që intervistojnë në trotuare, me drejtues gazetash mediokër, që shqetësohen se qeveria po harxhoka miliona dollarë për rrugën Durrës-Kukës, e për të cilin do të kishte qenë më me vend të rregullo-

heshin rrugicat e Tiranës, nuk mund të presësh sjelljen në ekran, në shtyp etj., mendime të opinionit publik e nga të cilat politikëbërësit shqiptarë të thurnin planet e zhvillimit afatshkurtër, afatmesëm e afatgjatë. Masmedia në Shqipëri, për fat të keq, nuk ka detyrë parësore hetimin, mbledhjen dhe përpunimin e opinionit publik, por mediatregun, të përbërë nga interesa të ngushtë individësh e grupesh politike, konkurren, që punojnë me vete dhe për vete.

Natyrisht, rruga Durrës-Kukës është vonuar kryesisht për arsye gjeopolitike të para viteve 1990, vonesa e saj e mëtejshme nuk mund të quhet asgjë më tepër se krim kombëtar. Rruga e Arbërit, një rrugë mbi 2-mijë vjeçare, që lidh pjesën lindore të vendit me Tiranën, bregdetin, portin e Durrësit dhe perëndimin e industrializuar e anasjelltas,



Pamje nga pjesa lindore e lugines së Matit

është një domosdoshmëri që i ka kaluar koha këtu e 75 vjet më parë, qysh me devijimin në aksin Krujë-Qafësh-tamë-Burrel, aks sot i vdekur. Rrëshen-Lis-Qafë Murrë-Peshkopi, aks gjithashtu i vdekur, aksi i "Rrugës së Dritës", aks tërësisht antiekonomik dhe dëmshjellës që ka rreth 50 vjet që na vjedh rëndom e për gjithë ditën xhepat, kohën, investimet e munguara, interesin për të vetëinvestuar, prodhuar, tregtuar e që është më e rëndësishmja po shoqërohet me braktisje marramendëse të trojeve të të parëve tanë fisnikë, që turku për 500 vjet nuk arriti ta realizonte. Perandoria romake na la të qetë në trojet tona, kultura romake mungon në Mat. Perandoria Osmane na la të varfër e pa rrugë se dhe ne matjanë e dibranë bashkë nuk e lamë të qetë as për pesë muaj, për pesë shekuj me radhë, regjimi i Zogut nisi të bënte, nuk diti si të bënte, s'pati dhe kohë të brente, regjimi komunist 50 vjeçar ndërtoi si mudi e voli sa mudi.

Po regjimi postkomunist? Mjafton të marrësh rrugën për Burrel, Klos e Bulqizë e më tej të shohësh në të dy anët e saj dhe mjafton fjala e huaj "No Comment". Rrugë për të ardhur keq, miniera të privatizuara, ku secili punon në kokë të vet e për hesap të vet, nuk di se ç'nxjerr dhe përse e nxjerr, nuk di se ç'le dhe përse e le, nuk di se ç'shet, kujt ia shet dhe sa ia shet. Uzinë ferrokromi që duket si objekt i dalë nga ndonjë luftë botërore, jo si objekt i rëndësishëm i industrisë së vendit, që vetëm 10-12 vjet më parë prodhonte rreth 30 000 tonë ferrokrom me vlerë 24 milionë dollarë në vit. Kromi anashkalon uzinën e Burrelit, shitet s'di ku shitet, punëtorët ngrohen në diell e qyteti vdes çdo ditë e nga pak. Fabrika pasurimi, impiant seleksionimi me teknologji bash-

këkohore rrinë pa punë. Përse? Askush nuk e di sepse. Traverbank gjigant i hapur në rreth 5700 ml thellësi, vetëm 1300 ml pa vajtur në projekt nuk vazhdon. Përse? Askush nuk e di sepse. Hekurudhë e zhvilluar në 60% të saj, e braktisur. Përse? Askush nuk e di sepse. Qytet minatorësh i braktisur i rrënuar i pajetë. Përse? Askush nuk e di sepse. Pyje të shkatërruara, degraduara, ku pritet çdo ditë, male lakuriq ku erozioni bën kërdinë, askush nuk thotë ndal, të gjithë bëjnë sikur e ruajnë e të gjithë vjedhin, pritet e nuk mbillet. Përse? Askush nuk e di sepse. Po shteti ku është? Ariu shtet është në gjumë e s'di se kur do të zgjohet e s'ka si të zgjohet i shkreti. Sapo nis t'i dalë gjumi, mjeshtra të sprovuar të korrupsionit me shiringa në duar i bëjnë injeksione gjumësjetëse. Dhe gjumashi shtet apo shteti gjumash, thuaj si të duash, fle, fle, fle.

Mati është i njohur për vallen dyshe të burraveose "Zebekçja", siç e quajnë vendasit, fituese në disa festivale kombëtare, gjithashtu, vallja dyshe e burrave është e njohur e kërcehet dhe në Dibër. Matjanët, të shquar në shekuj për zgjuarsit e inteligjencë, që kanë nxjerrë nga kumti i tyre princa dhe mbretër, burra shtetarë, udhëheqës brilantë e dinakë, gjeneralë, pashallarë që kanë drejtuar legjione të perandorisë në betejat të përgjakshme e kanë dalë fitues, nuk duhet të gënjejnë nga shtetarë hileqarë e të paskrupullt që nëpër fushata elektorale, premtojnë hapje tuneli diku në perëndim të vargmaleve Krujë-Dajt drejt Burrelit, me gjatësi disa mijëra

metra që as ka filluar e s'ka për të filluar kurrë. Matjanëve dhe dibranëve ju takon që vallen e Rrugës së Arbërit ta hedhin së bashku, për të mirën e përbashkët. Ju takon, gjithashtu, që të zgjojnë nga gjumi e të ftojnë në valle pushtetarë lokalë e qendrorë, deputetë, ministra, t'ju kërkohet leximin e votës së tyre dhe në zgjedhjet e fundit t'u kujtojnë që të mbajnë premtimet e dhëna, se do të ketë dhe në të ardhmen zgjedhje, por nuk do të pranojnë më premtime boshe butaforike, inskenime mjerane për fillim investimesh me buldozerë e fadroma e që nuk vazhdojnë më shumë se disa orë. Ju takon, gjithashtu, t'ju kërkohet atyre të përlllogarisin me lapsin e financiarit humbjet që shkaktohen çdo ditë, çdo muaj e suksesivisht vit pas viti nga transporti në qarkullimin e mallrave, njerëzve etj., për një investim të vonuar e të munguar, që s'duhet të vonojë më tej. Kolegët e mi të nderuar, Prof. Dr. Bashkim LLESHI, Dr. Vesel HOXHA etj., në numra të kaluar të gazetës "Rruga e Arbërit", kanë trajtuar me kompetencë shkencore resurset e rrethit të Dibërës, studimin e fizibilitetit të bërë për Rrugën e Arbërit, studimin gjeologjik të aksit, leverdinë ekonomike që vjen nga hapja e saj etj. Hapja e një rruge të re nuk lëndon askënd, nuk mënjanon askënd, përveçse hap perspektiva dhe mundësi të reja, kjo është kryesore dhe kjo duhet pasur mirë parasysh. Duke përfunduar këtë shkrim dua të kujtoj një thënie për Romën nga ROLAN: "Shteti dhe shoqëria shpeshherë kanë qenë të detyruar të marrin në konsideratë opinionet e njeriut të ndershëm, i cili nuk ka në dorë armë tjetër përveç forcës së fjalës."

(Fotot janë të autorit)



Pamje nga perëndimi i fshatit Plani i Bardhë

Nga XHEMAL DOMI

(Vijon nga faqja 1)

Nevoja për shkollë shqipe bëhej edhe më i madh për shkak të shtimit të shkollave në gjuhën turke, bullgare etj., që synonin shkombëtarizimin e popullsisë shqiptare, veçanërisht në Dibër, ku ngjarjet politike dhe pozicioni gjeografik në kufi me shtete që kishin qëllime shoviniste ndaj vendit tonë, bëhej gjithnjë më kërcënues. "Edhe në Dibër – shkruante konsulli austro-hungarez i Manastirit, u rrit ndjenja e homogjenitetit dhe po kërkojnë shkollë, kulturë, me një fjalë zgjimin e kombit shqiptar".

Në vitet e fundit të shekullit XIX në Dibër zhvillonte veprimtari patriotike Seid Najdeni, i njohur si "Hoxhë Voka", një nga pjesëtarët më aktiv të shoqërisë së Stambollit, që mbante lidhje me Naim e Sami Frashërin, Ismail Qemalin etj. Ky u përpoq që të hapte një shkollë shqipe në Dibër, por për shkak të reaksionit të fortë, nuk ia arriti qëllimit. Megjithatë shkrimi e leximi në gjuhën shqipe vazhdoi të përhapej edhe në malësi. Librat shqipe, nëpërmjet Shkupit, me anën e qiraxhinjve besnikë shpërndaheshin në Dibër, Zerqan, Homesh, Bulqizë, Bllacë, Luzni, Lurë, Gollobordë, Rekë etj.

Krahas Seid Najdenit në lëvizjen patriotike arsimore në Dibër dallohet edhe Hamdi Ohri, i cili ndihmoi në zgjerimin e përhapjen e shkrimit shqip në këtë krahinë. Qeveria Turke mori masa për t'i prerë rrugën kësaj veprimtari të rrezikshme. Hamdi Ohri u arrestua dhe u mbajt në burg katër vjet (1895-1899). Pothuajse të njëjtin fat pati edhe Said Najdeni, i cili u internua në Edrene. Por Hamdi Ohri edhe në burg organizoi një kurs për mësimin e shqipes, ku shumë shqiptarë, kur dolën nga burgu dinin të shkruanin e të lexonin shqip. Në këtë mënyrë, siç raporton konsulli austro-hungarez nga Manastiri, dibranët ishin vënë në lidhje me Haxhi Zekën e Pejës me Murat Toptanin dhe me kolonitë shqiptare të Bukureshtit, Sofjes etj., prej nga silnin libra e gazeta shqipe dhe me përpjekje të përbashkëta, ndonëse pa pas mësues e shkollë, brenda një kohe të shkurtër, mësuan patriotike dhe sjelljen e botimeve shqip në Dibër kontribuan në këtë kohë edhe Kadri Fishta e Selim Rusi. Kadriu ishte furnizues i ushtrisë turke dhe si i tillë kishte mundësi të lëvizte lirishit dhe të kryente detyrat patriotike.

Të gjitha këto dhe ngjarjet politike të vitit 1899, bënë që në Dibër të organizohen shumë mbledhje ku shprehej solidariteti me Kosovën, bësheshin përgatitje për t'i bërë ballë rrezikut të copëtimit, pa harruar luftën kundër sundimit shekullor turk dhe kërkesat për shkollën shqipe. Kërkesa e fundit ndiqej me vëmendje dhe i tmerronte diplomatët e huaj, prandaj konsulli rus i Manastirit raportonte në fillim të dhjetorit 1899 se "... dibranët tani nuk do të kufizohen me kërkesën për ndërrimin e mytesarifit, por do të kërkojnë edhe hapjen e shkollave në gjuhën shqipe". Nuk vonoi shumë dhe patriotët dibranë hartuan një kërkesë të firmosur nga 30 firma për njohjen dhe lejimin e sh-

Dibra në rrugën e dijes



kollave shqipe. Kërkesa iu dorëzua të dërguarve të Sulltanit, mareshallëve, Hasan Tahsin dhe Telat Pasha. Në kërkesë thuhej: "Meqenëse në qytetin tonë, Dibër, flitet vetëm shqip dhe fëmijët e vendit nuk kanë pasur mundësi të marrin mësim legalisht dhe të stërviten në gjuhë amtare... në qoftë se lejohet përgjithësisht, arsimi popullor...". Përkishtë në këto rrethana u lirua nga burgu Hamdi Ohri me porosi që të mos përzihet në punët e Lidhjes në Dibër. Por Hamdiu rifilloi aktivitetin politik dhe në shtëpinë e tij në Ohër, fshehurazi hapi një shkollë shqipe me rreth 80 nxënës. Aktiviteti i tij ra në sy të autoriteteve turke. Sulltani dërgoi një "Komision arsimor" në Dibër për të hapur 100 shkollë të reja turqisht, por populli nuk i përkrahu, megjithëse gazetaret e Stambollit shkruan se komisioni ishte prit me entuziazëm nga shqiptarët. Nuri Beu, adjutanti i sulltanit, arrestoi dhe burgosi shumë patriotë, në mes tyre edhe Hamdi Ohri. Nuri Beu kishte filluar të konfiskonte edhe librat shqipe që gjendeshin në Dibër.

Veprimtaria e Nuri Beut i zemëroi dibranët. Në korrik të vitit 1901 një shqiptar e vrau në mes të pazarit Nuri Beun dhe u largua qetë-qetë prej qytetit. Jendja në Dibër ishte tepër e acaruar, ku, siç shprehej konsulli austro-hungarez i Manastirit më 8 mars 1902, gjendej pika e gravitetit të situatës.

Në këto rrethana, kur lëvizja kishte marrë zjarr, dibranët mendonin të ngrinin vetë shkollë shqipe edhe në pikat më të rëndësishme të sanxhakut, sidomos në Malet e Dibrës. U vendos të hapeshin 7 shkollë shqipe: Dy në Dibrën e sipërme, tri në Dibrën e Poshtme dhe dy në Mat. Konkretisht shkollat do të hapeshin në fshatrat Çidhën, Muhurr dhe Luzni në Dibër të Poshtme, Zogje dhe Homesh në Dibër të Epër, Lis dhe Çullinjë ose Çukë të Matit. Situata e krijuar bëri që edhe fshatra të tjerë të mendojnë për hapje shollash shqipe ose për t'i kthyer shkollat ekzistuese të huaja në shkollë të gjuhës shqipe.

Ndonëse ishin bërë të gjitha përgatitjet, aksioni i hapjes së këtyre shkollave nuk u kurorëzua me sukses. Austro-hungaria, nga ku pritej ndihma, u tregua tepër e rezervuar. "... Aksionin përkatës, i shkruante ministri i jashtëm austro-hungarez, konsullit të tij në Manastir më 10 mars 1902, për arsye që kuptohen lehtë, jemi të detyruar t'ia lemë ekskluzivisht

popullsisë dhe nuk donte të angazhohej për ato shkollë dhe fatin e tyre".

Në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX shkrimi shqip dhe shkollë shqipe kishin bërë përparime të dukshme, ndonëse pa shkollë përkatëse, pa mësues të përgatitur, me mjete të kufizuara dhe fshehurazi, që të mos diktoheshin nga armiqët e shumtë, të vjetër e të rinj. Lëvizjet e armatosura, mbledhjet, kuvendet e Kongreset e zhvilluara, sidomos Kongresi i Manastirit, i Dibrës, i Elbasanit dhe mbledhje e veprimtari të klubeve, bënë që lëvizja kombëtare të shkonte përpara.

Përballë shkollave në gjuhë të huaj, turke, arabe, greke, serbe, bullgare etj., rilindësit tanë të mëdhenj dhe patriotë vinin arsimin kombëtar, shkollën



shqipe. "Shqipëria ka nevojë të madhe për dritë – shkruante gazeta "Dielli" – po drita duhet të jetë thjesht shqiptare".

Me idealet dhe platformat e rilindjes iu përkushtuan atdhetarët tanë të mëdhenj edhe çështjes së arsimit kombëtar pas shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor 1912. Por luftërat ballkanike të 1912-1913 dhe sulmet serbe, malazeze e greke për pushtimin e copëtimit e tokave shqiptare, pushtimi i Kosovës dhe i viseve shqiptare në lindje si dhe shtrirja e ushtrisë serbe në pellgun e Drinit, çështjen e shkollave jo se e harruan, por në plan të parë doli mbrojtja e çdo pëllëmbë toke arbërore, ku edhe dibranët derdhën edhe gjakun e tyre. Kemi parasysh betejën e Kolosianit, kryengritjen e 1913-ës, djegiet, masakrat serbe, shpërnguljet e popullatës shqiptare nga tokat e pushtuara etj., në vitet 1912-1921.

U desh të pritej viti 1914, kur me vendim të qeverisë shqiptare, të dërgoheshin në Dibër 3 mësues për të hapur për herë të parë 3 shkollë, të cilat do të

vinin themelet e shkollës shtetërore shqipe në Peshkopi, në Sllövë dhe në Trebisht. Mësuesit e parë të tyre Haki Sharofi në fillim në Peshkopi dhe pak më vonë në Sllövë dhe Ramiz Qatja në Trebisht qenë kuadrot e parë që i hapën rrugën arsimit shtetëror shqip në Dibër. Kup-tohet sa jehonë pati hapja e këtyre shkollave dhe sa gëzim e shpresa ngjalli në popullin arsimdashës të Dibrës ky akt.

Por vijimi i shkollave, sa me gëzim filloi, u ndërpre shpejt. Plasi Lufta e Parë Botërore. Shqipëria u bë shesh lufte. Dibra përsëri shkelet nga ushtria famëkeqe serbe, e cila nga fundi i viti 1915, duke u tërhoq nëpër Shqipëri, vrau e masakroi njerëz të pafajshëm. Vendin e saj e zunë forcat austro-hungareze dhe bullgare dhe zija e bukës që bëri kërdinë. Si kudo

Okstun etj, më 1922.

Vit me rëndësi për Dibrën në fushën arsimore ishte viti 1923, kur në një shtëpi private, në Qafë të Pazarit, në Peshkopi, u hap internati "Dibër", i cili dy vjet më vonë do të transferohej në Kastriot, në ndërtesën që ishte nis për zyrat e Prefekturës së Dibrës, ku do të ishte edhe qendra e Dibrës, por që pas vrasjes së Elez Isufit, tarafi i Sulë Shehut bëri që qendra e prefekturës të mbetej në Peshkopi dhe ndërtesa mbeti përgjysëm në Kastriot. Kjo ndërtesë pas 1925-ës u bë një nga shkollat më të mira jo vetëm në Dibër, por në gjithë Shqipërinë.

Internati "Dibra" u drejtua nga figura të ndritura të arsimit si Ferid Jegeni, Haki Sharofi, Sali Morina, Ahmet Imami, Ferid Imami, Rifat Spahiu etj. Aty dhanë mësim dhe lanë emër të pashlyeshëm mësues si Petër Elezi, Adem Jahja, Muharrem Musa, Jahja Damnori, Xhetan Elezi, Beqir Spahiu, Hamit Muça etj.

Në Peshkopi, gjatë gjithë periudhës së sundimit të Zogut, kanë funksionuar dy shkollë, një shkollë mashkullore dhe një shkollë feminare. Shkollë feminare ka pas edhe në Zerqan dhe në Trebisht, por u shkrinë në shkollat mashkullore. Në Dibër numri i shkollave deri më 1938-1939 ishte i vogël. Gjithsej ishin 42 shkollë më 1938-1939 më 63 mësues dhe më 2056 nxënës.

Detyrimi shkollor sipas ligjës organike të arsimit, nuk u zbatua gjatë 15 vjetëve të regjimit të Zogut, për arsye të mungesës së lokaleve shkollore, mungesës së fondeve për arsimin dhe mungesës së mësuesve.

Me gjithë vështirësitë që hasi arsimit në Dibër dhe gjetkë, nuk e humbi karakterin kombëtar dhe edukimin patriotik. Në Dibër radhët e njerëzve që dinin të shkruanin ishin shtuar. Krenaria kombëtare ishte rrit te brezi i ri. Kjo duket te manifestimet kulturore e sportive, të cilat pas vitit 1928 drejtoheshin nga instruktorë italianë. Mësuesit e nxënësit e Internatit "Dibra" të Kastriotit dhe të Peshkopisë në manifestimet e mbylljes së vitit shkollor, visheshin me rroba me ngjyrat e flamurit kuq e zi. Në shfaqjet teatrale, që luheshin nga mësuesit e nxënësit jepeshin pjesë me përmbajtje patriotike si "Dibranja e mjerueme" e Haki Stërmillit etj., të cilat shiheshin me kënaqësi nga populli dhe duartrokiteshin nxehtësisht për interpretimin e mirë.

Intervistë me prof. Hajri Shehun, punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë

Po punojmë për "Fjalorin me fjalë e shprehje të Ujemujes"


Publiku i gjerë është njohur me lajmin se ka dalë nga shtypi "Fjalori i gjuhës shqipe" (2006). Ju jeni bashkëhartues. Ç'është ky fjalor?

Do të donim t'ju thoshim më parë se kemi një traditë të vyer 370-vjeçare në hartimin e fjalorëve. Për fjalorët dygjuhësh e terminologjikë (të degëve të shkencave e të teknikave) mund të krahasohemi me vende të zhvilluara evropiane. Në shqipëri, fjalori i parë latinisht-shqip është botuar nga Frang Bardhi më 1635. Në Britani, fjalori i parë latinisht-anglisht është botuar më 1588. Fjalori i gjuhës shqipe i Kostandin Kristoforidhit është botuar më 1904 në Athinë dhe fjalori i parë shpjegues kombëtar i gjuhës shqipe, *Fjalori i gjuhës shqipe* është botuar më 1954 në Tiranë. Siç dihet, më pas, më 1980, 1984, 2002, janë botuar fjalorë të tjerë kombëtarë të gjuhës shqipe. Më 2002 dhe 2004 janë botuar edhe dy fjalorë sinonimikë të gjuhës shqipe. Janë botuar mbi 140 fjalorë terminologjikë shqip-gjuhë e huaj e gjuhë e huaj-shqip. Është në rrjet Fjalori elektronik i gjuhës shqipe dhe Autokorrektori i gjuhës shqipe. Në librin "Leksikografia shqipe – trashëgimi dhe perspektivë" (Tiranë, 2005) ka një bibliografi të gjerë të trashëgimisë dhe të arritjeve në fushën e hartimit të fjalorëve. Në 370 vjet, i takon të jetë botuar gati një fjalor në vit. Gjeografia e fjalorëve të shqipes ose me shqipen shkon nga Tirana, Prishtina, Kalabria etj. deri në Gjermani e Holandë, Angli e Finlandë, Amerikë e Kinë, Itali e Bullgari, Greqi e Rusi, Maqedoni e Hungari, Serbi e Poloni, Danimarkë e Siri, Austri e Francë, Turqi e Rumani etj.

Fjalori i gjuhës shqipe (2006) është vepër e re, por, siç thuhet edhe në parathënieën e tij, "ruan në shkallën më të lartë vlerat kryesore të fjalorëve të mëparshëm shpjegues të shqipes" dhe ka synuar "t'i rritë dukshëm këto vlera" me fjalë, kuptime etj. Në këtë fjalor (me rreth 48 000 fjalë) janë përfshirë shumë fjalë, shprehje e kuptime që përdoren sot në shqipëri, që nuk kanë qenë në fjalorët e mëparshëm të shqipes. Këto fjalë të reja janë nxjerrë nga letërsia e sotme artistike, shkencore, politike, fetare, nga fjalorët dygjuhësh, nga tekstet shkollore, nga gazetatat, nga fjalorët krahnorë etj. Shpresojmë të jetë shumë i përdorshëm e i pëlqyer nga mësuesit, studentët, nxënësit e shkollave të mesme, publicistët, shkrimtarët, përkthyesit etj., sepse ka synuar të jetë i tillë me zgjedhjen e fjalëve, të shprehjeve e të kuptimeve e edhe me sintezat e shpjegimeve etj. Besojmë që lexuesit e nderuar të gazetës suaj janë njohur me këtë fjalor nga recensionii i prof. Enver Hysës e ne nuk na mbetet vetëm të përsërisim, po të vijojmë më tej. Besojmë, gjithashtu, që fjalori të ketë hyrë në bibliotekat e tyre e të jetë bërë libër tryeze. Ai ka format të atillë, që mund të merret edhe në çantë.

Më konkretisht, në ç'drejtime është pasurur ky fjalor në krahasim me fjalorët e mëparshëm të shqipes?

Besojmë se jemi në një mendje: Çdo ribotim sjell diçka të panjohur për lexuesit, kurse në një fjalor të ri e reja është shumë më e madhe. Në fjalor, e reja është detyrë e përhershme dhe punë e përhershme. Në këtë fjalor kanë ardhur fjalë e formime të reja fjalësh që sjellin nocione e dukuri të reja të kohës, që janë terma të rinj, sidomos nga fusha e informatikës, e ekonomisë dhe e financës, e politikës, e pluralizmit etj. Fjalori nuk mund të mos merret nga veprat e shkrimtarëve të njohur, nga fjalëformimet e tyre të reja, nga kuptimet e reja që u japin fjalëve, nga fjalët e shprehjet me burim popullor që ata pasqyrojnë a të formuara sipas gjedhes (modelit) popullore etj. Kështu, p.sh. në fjalor ka formime të l. Kadaresë (*fortafolës për altoparlant, arkëmort për arkivol, dehashpirt për ek-stazë* etj.). Në fjalor ka mjaft fjalë të reja që vijnë nga shtypi i sotëm pluralist, nga gazetaria televizive e radiofonike, nga ligjërimet fetare etj. (*miush / maus, menaxhoj, evazion, ekstremizoj, indeksoj, kolaps, islam* (si emër), *ezan, kible* etj.). Brenda kritereve shkencore të përzgjedhjes së fjalësit, janë përfshirë fjalë, shprehje e formime me prejardhje nga gjuha e popullit, të papasqyruara a të panjohura deri më tani (nga ndajfoljet më -shëm, emrat më -ajë / -najë etj. të të folmeve të Veriut: (*vëmendshëm, habitshëm, zemërueshëm, vathnajë, vjedhnajë* etj.). Në fjalor nuk ka politikizma dhe ideologjizma.



Prof. Hajri Shehu

Si ndikojnë fjalorët në kulturën gjuhësore?

Gjuha kombëtare është formë e kulturës kombëtare. Kultura kombëtare formësohet me gjuhën. Nga ana e saj, kultura (shkolla, arsimit, teatri, radioja, televizioni etj.) ndikojnë në gjuha duke fuqizuar normën, standardin. E thënë më të mënyrë më të përgjithshme, gjuha nuk mund të mos varet nga kushtet në të cilat jeton shoqëria, nga niveli i zhvillimit të saj, në fund të fundit, nga njerëzit që e flasin gjuhën, nga vepërtaria e tyre, e cila mund të formësohet edhe si program i politikës gjuhësore (kujtojmë programin e Rilindjes Kombëtare). Nuk mund të rivinin, le të themi, *bashki, komunë, prefekturë, qark* etj. pa ndryshimet politike të viteve '90 të shekullit të kaluar. Leksiku (leksiku është tërësia e fjalëve të një gjuhe) lidhet më drejtpërdrejt me ndryshimet shoqërore, politike, kulturore etj. të shoqërisë. E, fjalorët i pasqyrojnë ato domosdo. Fjalorët janë ndërmjesuesit midis gjuhës e folësve të saj. Në një kuptim më të ngushtë, gjuha është institucioni kulturor, domethënë, ajo ruan trashëgiminë kulturore të ligjërit (të të folurit) të bashkësisë. Më mirë se 'ka si përkufizohet: visari i gjuhës. Fjalorët e pasqyrojnë këtë trashëgimi, këtë visar sipas prerjes së tyre e tipave të tyre. Fjalorët i shkojnë pas gjuhës, e ndjekin atë. Fjalorët nuk janë ligjëbërës. Do të ishte doktrinë e gabuar nëse fjalorët do të veçoheshin nga marrja e dhënia me komunikimin njerëzor. Por, sigurisht, ata kanë të drejtë të zgjedhin e të përzgjedhin (besojmë, këtu vjen thelbi i përgjigjes për pyetjen tuaj); p.sh. një fjalor i gjuhës standarde, doemos do të zgjedhë e do të përzgjedhë: të tillë fjalorë e pasqyrojnë gjuhën standarde, madje, nuk e teprojmë po të themi, edhe vetë rrugën si është bërë ajo standarde; ata bëhen vetë simboli i gjuhës standarde e këtë është edhe rruga e ndikimit të tyre.

A mund të na e thoni pak më konkretisht: Si?

Po. Një shembull. Ka një standard të pranuar, ka një normë drejtshkrimore, gramatikore etj. Fjalori kombëtar është i detyruar ta pranojë dhe ta pasqyrojë atë. Por në veprimtarinë e përditshme njerëzit mund të sjellin a të përcjellin fjalë, trajta fjalësh etj. që janë normale në një variant tjetër të gjuhës, le të themi, në dialekt a të folme por jo në standard. Mirëpo fjalori i gjuhës standarde nuk merret me të tilla gabime a shmangie dhe nuk i pasqyron ato. Ai nuk lejon gjithçka, nuk pranon gjithçka. Përderisa ka një normë (standard) drejtshkrimore, drejtshqiptimore, gramatikore e fjalëformuese etj., fjalori nuk pranon shpërdorime të saj. Fjalori ka për detyrë ta mësojë e ta edukojë gjuhësisht përdoruesin. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet se fjalorët nuk përcaktojnë kufij tokësorë të përdorimit të mirë të shqipes, por ata shembullsojnë kujdesin gjuhësor të folësve të kulturuar (të kulturuar gjuhësisht), çka sjell të mira shoqërore dhe etike. Fjalorët i drejtohen masës për të ngritur kulturën e ligjërit të shkruar dhe të folur. Thënë shkurt, fjalorët japin këshillimet e ligjshme gjuhësore: ç'është mirë. Në një kuptim më të ngushtë, Fjalori i gjuhës shqipe është

pyetësor praktik. Ai i hap lexuesit tablonë jash-tëgjuhësore të botës. Lexuesi mëson diçka të re, por edhe përforcon dijet jo të plota për një fjalë të caktuar etj. Një shembull i thjeshtë: Njerëzit i drejtohen zakonisht fjalorit për fjalë, shprehje frazeologjike, shkurtime e shkurtesa, bashkëlidhje fjalësh etj. të panjohura. Në vitin 1981, siç dihet, vëllezërit tanë kosovarë u fajsuan nga pushtuesit serbë si "irredentistë". Fjala u përdor shpesh në gazeta, në radio e në televizion.. "Na sqaroi Fjalori, - do të thoshin shumë lexues të gazetave e dëgjues e shikues të radios e të televizionit, - se nuk e kishim ditur këtë fjalë". Sigurisht. Fjalori është libër për të gjithë.

Ju thoni se janë përfshirë në Fjalor edhe fjalë, shprehje e formime nga gjuha e popullit. A duhet të përfshijë fjalë e shprehje popullore dialektore e krahnore një fjalor shpjegues i gjuhës shqipe standarde?

Gjuha e përgjithshme, mbarëkombëtare ka disa variante. Një ndër variantet e saj është gjuha standarde. Është varianti më i përgjithshëm, më i pranueshëm i komunikimit. U tha se shoqëria ndikon mbi gjuhën. Por edhe vetë gjuha nuk rri pasive në marrëdhëniet me shoqërinë. Në një etapë të caktuar të zhvillimit të saj historik ajo hedh tej lëkundjet në normë, hedh tej huazimet e panevojshme etj., pra bëhet standarde. Ne e kemi një gjuhë të tillë. Argument për këtë është edhe fjalori kombëtar i gjuhës shqipe, siç janë edhe gramatika e saj, drejtshkrimi e drejtshqiptimi, fjalëformimi etj. Përmendëm të parin Fjalorin, sepse vetëm gjuhët e standardizuara e kanë organizuar leksikon në fjalorë shpjegues. Në gjuhët jostandarde nuk ka fjalorë të tillë, ka vetëm fjalorë dygjuhësh: gjuhë e huaj – gjuhë vendi. Një gjuhë prestigjioze e meriton një fjalor kombëtar. Kuptohet, nga ana tjetër, një fjalor i mirë e rrit më tej prestigjin e saj.

Më lejoni të kapërcejmë pak nga përgjigja se besojmë, ia vlen të theksohet. Ne e kemi një gjuhë standarde. Një arritje e madhe kombëtare. Nuk mund të ishte ndryshe? Edhe mund të ishte. Ka shembuj. Është rasti i greqishtes. Siç dihet, në shek. IV, p.e.s., dialektet e vjetra filluan të shuheshin dhe të zhvillohej një gjuhë e përbashkët, e ashtuquajtur koinë. Por zhvillimi i kësaj koineje në një gjuhë të vërtetë letrare u ndërpre shpejt për arsye të një prirjeje vjetërsuese (arkaizuese) që mbizotëroi në bashkësitë greke në shekujt e parë të erës së re: gjuha letrare do të ishte aq shumë afër modeleve të Atikës së shekujve V, IV p.e.s. Kjo prirje vjetërsuese ka sjellë në Greqi një diglosi të fuqishme, që në njëfarë mënyre mbijeton edhe sot: *kathareusa* (e pastër) dhe *demotiki* (popullore) janë dy forma konkurruese të greqishtes letrare; nëse nuk mësohet në shkollë, *kathareusa* nuk mund të kuptohet nga një grek, lëre pastaj të përdoret në shkrim e edhe në të folur. Kjo dukuri nuk është e panjohur edhe në vende të tjera të botës. Kështu ka qenë rasti me kinezishten klasike. Arabishtja e sotme standarde është shumë afër arabishtes klasike. Kur'ani nuk mund të lexohet e të kuptohet pa e njohur arabishten klasike. Kjo situatë nuk njihet të shqipja. Për shumë arsye. Brendagjuhësore e jashtëgjuhësore. Nuk është vendi për t'i shkoqitur.

Të kthehemi të pyetja tuaj. Siç dihet, objekt themelor i fjalorëve kombëtarë është gjuha e shkruar. Pas saj, edhe gjuha e folur – e mjeteve të informimit masiv, e konferencave, e fjalimeve etj. Por edhe gjuha bisedore, sepse, në parim, një fjalor shpjegues duhet të përfshijë atë që realisht përdoret në gjuhë. Fjalori shpjegues kërkohet të jetë një libër referimi për përdoruesit e tij. Si i tillë, mungesa e leksikut jonormativ është parimisht zgjidhje e padrejtë. Përjashtimi i fjalëve të ligjëritimit bisedor, krahnor-bisedor, madje, edhe të ligjëritimit të thjeshtë (vulgarizimeve) etj. do të thotë, në thelb që hartuesi e ka përcaktuar që më parë atë rreth teksteve që përdoruesit duhet të kuptojë, të përkthejë etj., kur tekste bisedore me fjalë krahnore etj. gjenden në letërsinë artistike tregimtare, në folklor etj. Kjo do të thotë që autori i fjalorit harton një libër të paragykimave të veta. Atëherë? Atëherë, nuk duhen shpërfillur as ato njësi që qëndrojnë në anërrugë të gjuhës standarde. Në fjalorët kombëtarë të gjuhës së sotme shqipe, brenda prerjes së tyre e tipit të tyre, nuk ka kufizime të tilla, nuk ka qëndrim joobjektiv ndaj vepërtarisë gjuhësore. Fjalorët kombëtarë

të shqipes janë burim informacioni edhe për fjalë a shprehje jonormative. Sa e si? Ka parime dhe kritere shkencore e teknike për këto.

Pas këtij sqarimi, besojmë se i jemi përgjigjur me "po" pyetjes suaj, por mund të shpjegojmë disi atë "sa-në" dhe "si-në". Dialektet e të folmet truallsore të shqipes kanë shërbyer e shërbejnë si burime të pazëvendësueshme të pasurimit të fjalorëve kombëtarë. Gjuha standarde dhe fjalori i saj ushqehen nga dialektet e të folmet. Në mënyrë të figurshme do të ishte kështu: gjuha standarde është deti që ushqehet nga dy lumenj të mëdhenj – Drini e Vjosa. Ne që kemi pasur rastin të jemi bashkëhartues, kemi ngulitur në mendje edhe fjalë të veçanta e të folmen nga kanë ardhur ato (p.sh. *ylltoj, udhoj e udhohem, sypafjetur, parsë* (për *fasadë*), *ballosh, brezatar* etj., nga e folmja e Dibrës (Ujemuja), që *përfush* ka ardhur nga Guri i Bardhë, (Mat etj.). Për këto prurje ka studime e statistika nga studiues leksikografë. Nëse ka ende njësi të pakodifikuara, të papërfshira në Fjalor, kjo është thjesht për mosnjohje ose sepse tipi i fjalorit të kufizon. (Fjalorët janë si xeherori në nëntokë e hartuesit, si gjeologët. Gjeologu vendos që në këtë vit a në këto vite shkëmbi xeheror do të pritë kaq e aq. Më pas do ta shtrijë prerjen. Edhe hartuesit e fjalorëve kështu bëjnë). E, megjithëse "Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980) e pas tij, edhe fjalorë të tjerë të shqipes nuk hyjnë tek tipi i madh (i fjalorit), japin shembull të mirë për pasqyrimin e fjalëve e të shprehjeve popullore. Madje, një ndër veçoritë dalluese të "Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe" (1980) e edhe të "Fjalorit të shqipes së sotme" (1984, ribotuar më 2002) e të "Fjalorit të gjuhës shqipe" (2006) e të "Fjalorit sinonimik të gjuhës shqipe" (2004) është se kanë përfshirë në fjalësin e tyre një numër jo të vogël fjalësh popullore me prejardhje dialektore ose krahnore, të panjohura ose pak të njohura deri atëherë në gjuhën shqipe standarde. Kjo zgjidhje është krejt e ndryshme nga ajo e shumë fjalorëve shpjegues të gjuhëve të tjera standarde, si të bullgarishtes, të rumanishtes, të rusishtes etj., të cilët fjalët me burim dialektor e krahnor ose përgjithësisht, fjalët popullore e pasqyrojnë vetëm mbi bazën e përhapjes së gjerë të tyre, tej kufijve vendorë ose mbi bazën e përdorimit të tyre mjaft të gjerë në gjuhën standarde, sidomos në gjuhën e letërsisë artistike. Kjo zgjidhje që është dhënë në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe" (1980) "është mbështetur, - siç e ka shpjeguar e argumentuar prof. Androkli Kostallari, - në vetë kushtet e zhvillimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe në përgjithësi dhe përfundimisht me etapën historike në të cilën zhvillohet ajo". Një nga veçoritë e kësaj etape, - vë në dukje ai, - është mospërputhja midis pasurisë së madhe leksikore e frazeologjike të gjuhës së folur në tërësinë e dialekteve dhe pasqyrimin të kufizuar e në mënyrë josimetrike të kësaj pasurie në shkrime e botime të ndryshme, për arsye historike që dihen.

Kjo zgjidhje e drejtë teorike është mbështetur te parimi udhëheqës më i përgjithshëm për zgjedhjen e fjalësit (fjalëve). Sipas këtij parimi, "vlerësimi i çdo fjale (për ta futur ose jo në Fjalor) duhet të bëhet, në radhë të parë, sipas burimit dialektor, as sipas burimit letrar, por sipas vlerës së saj objektive në strukturën leksikore të shqipes së sotme letrare". Vlera objektive e fjalës është: a sjell emërtim të ri për gjuhën standarde, a sjell kuptim të ri a ngjyresë të re kuptimore, a zëvendëson një fjalë të huaj të panevojshme etj. Kuptohet, të tilla njësi janë me vlerë letrare potenciale, por që mund të fitojnë vlera reale, pra mund të fitojnë "të drejtën e qytetarisë" në gjuhën standarde, domethënë, mund të pasqyrohen në tekstet shkollore, në fjalorët terminologjikë, në mjetet e informimit masiv e sidomos, në letërsinë artistike. Për vetë rrezin e gjerë të vepërtimit të saj, si varianti më i gjerë i gjuhës sonë standarde, letërsia artistike ka mundësi më shumë se çdo fushë tjetër për t'i pasqyruar fjalët e shprehjet popullore. Të gjithë shkrimtarët tanë shquhen për pasqyrimin e fjalëve dhe të shprehjeve popullore. Ata kanë gjetur në gjuhën e popullit shprehjet më të holla artistike të mendimit njerëzor. Poetët, edhe poetizma. Lexojini veprat e Gjergj Fishtës, të Haki Stërmillit, Mitrush Kutelit, Jakov Xoxës, Ismail Kadaresë, Martin Camajt, Hivzi Sulejmanit, Skënder Drinit, Mehmet Elezit, Sulejman Krasniqit, Xhafer Martinit, Xhelal Ndreut, Petrit Palushit e të shumë të tjerëve edhe me këtë pamje, ►

Nga Sherif DELVINA, *Studios*

Kongresi i Dibrës është konsideruar si Kongres Kombëtar. Kështu me të drejtë e ka cilësuar atë gazeta "Liria" e Mit'hat Frashërit. Nga kjo gazetë citojmë:

"Pa dyshim fare, Kongresi i Dibrës quhet e para mbledhje kombëtare në Shqipëri, e para mbledhje ku e tërë Shqipëria të jetë takuar për të zgjedhur një punë të nevojshme për tërë vendin." "Për këtë Kongres të Dibrës, ku më tepër se 300 delegatë gegë, toskë, muslimanë, të krishterë ortodoksë, katolikë, hoxhallarë, prifterinj dhe shehlerë, erdhën nga çdo çipë e nga çdo kënd i Shqipërisë, themi është i pari kongres që ka mbledhur tërë vendin". (Gazeta "Liria", nr.56, viti 1909)

Në këtë Kongres morën pjesë 325 delegatë dhe shumica prej tyre ishin shqiptarë. Për këtë gazeta "Osmanischer Lloyd", ne artikullin e saj "Programi shqiptar", botuar në "Dielli", shkruan: "Duke vënë re kompetencën që ka kjo Dietë ngaqë është një kongres prej gjithë shqiptarëve, programi që u shtrua shënon një hap të madh që të fitojnë shqiptarët idenë e shtetit kushtetues" Gazeta "Dielli", 3 shtator, 1909. Edhe gazeta "Lidhja ortodokse", pohon se "Kongresi i Dibrës i dha të kuptonte botës ngjalljen e kombit shqiptar, pra lindjen dhe progresin" (Gazeta "Lidhja ortodokse", nr.3, 1909).

Për Kongresin e Dibrës gazeta italiane "L'Italia all'estero" (Shqipëria jashtë shtetit, nr.18, 20 shtator 1909) shprehet kështu:

"Kongresi i Dibrës, pas zhvillimit të bisedimeve, mori vendime për zgjidhjen e disa çështjeve ekonomike të Shqipërisë.

Kongresi i Dibrës mori emrin Kongresi i kushtetutës së përbashkët shqiptar-osman. Ai kerkoi që në Shqipëri gjuhë shqipe të gëzojë liri të plotë, nëpunësat të dinë gjuhën dhe zakonet e vendit, kerkoi nga qeveria decentralizimin, keshillat e vilajeteve të kenë me tepër të drejta" (Gazeta "L'Italia all'estero", nr. 18, 20 shtator 1909)

Shqiptarët në Kongresin e Dibrës dhanë besën se do t'i qëndronin besnikë Kushtetutës. Ata në këtë Kongres dolën me kërkesa ekonomike dhe kulturore. Vlen të përmendet veprimtaria e zhvilluar nga klubi "Bashkimi" i Dibrës, nën drejtimin midis tjerëve edhe të Riza Rusit i cili zhvilloi një veprimtari të gjerë e të dendur, sidomos për levrimin e gjuhës shqipe e për të dërguar nxënës në normalen e Elbasanit. Ai ndihmoi në përgatitjen dhe organizimin e Kongresit të Dibrës (Haki Sharofi, Historia e Dibrës, v. I, Tiranë 1968 (cituar sipas M.Murrës)

A. Kadiu pohon: "Klubi Bashkimi i Dibrës edhe në Kongresin e Dibrës që u hap në korrik të vitit 1909, dëftoi një aktivitet të gjerë. Këshilli i këtij Klubi pati mbledhur disa herë delegatët shqiptarë të Kongresit për të biseduar dhe vendosur, në mënyrë gatimore mbi çështjet kombëtare që do të shohiste Kongresi." (Dr. Arian Kadiu, "Dibra e Madhe", monografi, Tiranë, 1996.)

Kongresi i Dibrës në emër të "Nyjave të para për bashkim", kerkoi nyjet e dyta të nevojshme që i shërbenin më së miri çështjes kombëtare. Para opinionit ndërkombëtar të asaj kohe, shpalosi kërkesat e veta në emër të kombit.

Kongresi i Dibrës iu kundërvu propagandës antishqiptare që bëhej në Europë. Shqiptarët cilësoheshin si përkrahës të regjimit të sulltan Hamidit. Në të vërtetë shqiptarët kishin punuar më shumë se popujt tjerë për të sjellë ne fuqi xhonturqit.

Xhavit Pasha vepronte në Kosovë kundër forcave kryengritese. Delegatët e Kongresit të Dibrës pranuan pesë nenet e bashkimit të propozuara nga xhon turqit, por me ndryshime të bera nga delegatët e Kongresit. Pjesa e dytë e programit prej 12 nenes "Nyjat e dyta të nevojshme" u propozuan dhe u

miratuan nga përfaqësuesit e rrymës kombëtare shqiptare. Një rol të rëndësishëm në këto ngjarje padyshim i përket kryetarit të këtij Kongresi, myftiut Vehbi Dibra, i cili ia doli që Kongresi t'i kryejë punimet me sukses. Ky Kongres që një manifestim i pavarur kombëtar shqiptar. Të 45 delegatët, nga nëntë për çdo vilajet, që u zgjedhën nga mbledhja e gjerë prej 325 delegatëve, ishin ata të cilët bënë që Kongresi të shndërrohej në tribunë luftarake për shpalosjen e kërkesave të mirëfillta të shqiptarëve, "të kërkesave më të avancuara të Levizjes Kombëtare Shqiptare" (Prof. Dr.Gazmend Shpuza, Në prag të pavarësisë Nju Jork, 1999, fq.3-62) Shtojmë se ata 45 delegatë këshilloheshin me 280 të tjerët.

Kongresi i Dibrës ishte një Kongres Kombëtar Shqiptar dhe këtë e tregon edhe pjesëmarrja e gjerë e atdhetarëve shqiptarë, të cilët na i numron "Historia e popullit shqiptar", ku lexojmë: "Vehbi Efendi Dibra, Sotir Peçi, Fehmi Zavalani, Dervish Hima, Loni Logori, Hafiz Au Korça, Liambi Kota, Abdyl Ypi, Aqif pashë Elbasani, Benjamin Nosi, Andrea Ballamaci, Qazim Beu, Isuf Karahasani, haxhi Ibrahim Efendi, Murat Aga, etj." (Historia e popullit shqiptar), v. II, Tirane, 2002

Në Kongresin e Dibrës përfaqësohej tërë Shqipëria së bashku me pakicat etnike në suazën e Perëndorisë Osmane. Të bën përshtypje kërkesa e Elezoviqit, i cili kërkonte që Kongresi kushtetues i përbashkët shqiptar-osman të quhet Kuvendi i Rumelisë Osmane, ose Kuvendi i Maqedonisë. Bukur i përgjigjet Hafiz Ali Korça: "Dhe me të thenit Kuvendi i Maqedonisë fitohet gje", se "Maqedonia domethënë Shqipëri e moçme. Zotëruesit dhe populli më i moçëm kanë qenë stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm." ose ajo e Haxhi Ibrahimit (kryetar i bashkisë së Shkupit), kur thotë: "Çdo anë e Kosovës është Shqipëri", apo e Qenan Manastirit: "...Dibra dhe vendi ku ka lindur zoti Elezoviq, që kur historia filloi të shënojë ngjyrat e botës, ka qenë atdheu i shqiptarëve dhe një pjesë e Shqipërisë."

Pas diskutimeve të zhvilluara lidhur me këtë çështje, emri i këtij Kongresi mbeti i pandryshuar.

Asambleja harton disa nene shtuese që përbëjnë nisjen drejt autonomisë

Vazhdojmë duke cituar René Pinon, "L'Europe et la jeune Turquie", (Europa dhe Turqia e re) Paris, 1911: "Komitetet e vilajetit të Maqedonisë vendosën të mbajnë në Dibër një mbledhje të përgjithshme, e para pas asaj të Ferizajit. Komiteti "Bashkim e Përparim" kerkoi ta kthejë këtë në dobi të tij, duke i dhënë një karakter jo vetëm shqiptar, por të përgjithshëm. Me kërkesat e tij, të gjithë bashkësitë maqedonase u ftuan të marrin pjesë. Në vilajetin e Kosovës, serbët e të gjithë kazave dërguan delegatët; bullgarët me përjashtim të atyre të Koprlyu dhe të Koçanës, abstenuan. Komiteti ("Bashkim e Përparim") delegoi Njazi Beun, heroin e Resnjës me disa oficerë. Banda e shkollës së arteve dhe të zanateve të Shkupit shkoi në Dibër, duke i dhënë kështu kësaj mbledhjeje një karakter thuajse zyrtar. Një program i përgatitur nën kujdesin e Komitetit Bashkim e Përparim që në fillim u pranua, por pastaj asambleja hartoi disa nene shtesë që përbënin një nisje drejt një autonomie pa u kërkuar në mënyrë kategorike, të paktën kështu ka shumë të ngjarë. Ajo (asambleja) kërkonte: pëlqimin e kandidatëve vendorë në emërimin e funk-

(23-29 korrik 1909)

sionarëve, të drejtën për çdo besim, të ketë shkolla kombëtare, të kremtohen ritet fetare në gjuhën kombëtare, të krijohet shkolla në të cilat mësimi të jepet në gjuhën shqipe, të ndërtohen hekurudha dhe rrugë, të thirret për çdo vit në një qytet maqedonas të caktuar me short një sezon i Kongresit osmano-shqiptar të bashkimit kushtetues."

Bota merr një përshtypje krejtësisht të gënjeshtërt mbi qëndrimin e shqiptarëve përballë regjimit të ri.

H. Charles Woods, ne "La Turquie et ses voisins", (Turqia dhe fqinjët e saj) Paris 1911 shkruan:

"Kongresi i Dibrës, që u mbajt në korrik, ishte organizuar nga anëtarët e komitetit shqiptar për t'u treguar bashkëpatriotëve të tyre se kishte ardhur koha për të diskutuar çështjet kombëtare nga ana politike. Rëndësia e këtij Kongresi qëndron jo vetëm për disa vendime që ai miratoi, vendime që dëshmuuan në mënyrë të padiskutueshme që populli shqiptar nuk mund të shtypej lehtësisht, por akoma më keq, siç u trajtua kohët e fundit nga xhonturqit. Kur turqit e rinj morën vesh se ky Kongres ishte propozuar për t'u mbajtur, vendosën që atë ta shfrytëzojnë në dobi të tyre. Për këtë qëllim, të gjitha bashkësitë e Maqedonisë u ftuan të çojnë përfaqësuesit e tyre në asambleshë e Dibrës. Vetë xhonturqit siguruan emrimin e disa përfaqësuesve nën drejtimin e Njazi Beut, heroit të Resnjës. Gjithashtu ata përgatitën një listë propozimesh për të cilën u munduan që Kongresi ta miratonte pa diskutime.

Kur delegatët mbërritën në Dibër, panë se numri i tyre ishte tepër i madh, kështu që i kalonte mundësitë për të diskutuar programin e hartuar nga xhonturqit. Ata morën vesh se 8 përfaqësues do të emroheshin anëtarë të një Komiteti Qendror për të shprehur interesat e secilit prej 5 vilajeteve turke që kishin dërguar deputetet në Kongres. Në fillim këta 40 deputete miratuan raportin e përgatitur nga turqit e rinj, raport që natyrisht ishte plotësisht favorizues për xhonturqit, pastaj ata shtuan disa nene shtesë, që tregonin qartë kërkesat e vetë shqiptarëve. Në numrin e rezolutave të miratuara nga Kongresi figuronte kërkesa për më tepër drejtësi ndër gjykata si dhe ndërtimi i shkollave të veçanta në Shqipëri. Delegatët, gjithashtu, kërkuan që t'i jepeshin kompetenca më të mëdha Keshillit të Përgjithshëm të çdo vilajeti, si dhe që shumica e të hollave e të dhjetës vjetore, e mbledhur nga qeveria, e cila ishte caktuar sipas të dhjetave të paguara gjatë 5 viteve të fundit, duhej të caktohej sipas pagesës së çdo viti, sic ka qenë vepruar në të kaluarën.

Disa fjalime energjike u mbajtën mbi dobinë e ndërtimit të rrugëve në Shqipëri. Gjithashtu u kërkuar të caktohej përfundimisht kufiri turko-malazez. Vetëm nenet favorizuese për turqit e rinj u botuan, kështu që bota mori nga ky Kongres një përshtypje krejtësisht të gënjeshtërt mbi qëndrimin e shqiptarëve përballë regjimit të ri."

Pritja e detegatëve në Kongresin Shqiptar të Dibrës

Lidhur me këte aspekt po botojmë fragmente të një relacioni me titull "Kongresi shqiptar i Dibrës" (cituar sipas "La nazione albanese", përkthyer nga gazeta "Journal de Salonique"), shkruar nga një delegat i këtij Kongresi që nuk është shqiptar prej gjaku, por që ka qenë i pranishëm në seancat e Kongresit me

cilësinë e anëtarit të delegacionit të dërguar për të përfaqësuar vilajetin e Selanikut. Atij i bën përshtypje korrektesia me të cilën u zhvilluan seancat e Kongresit, mikpritja e dhënë në Dibër prej kongresistëve dhe saktësia kushtetutore në çdo veçanësi të saj, e respektuar gjatë çdo seance të këtij Kongresi. Citojmë: "Organizatorët e Kongresit të Dibrës kishin bërë përgatitje të mëdha për të pritur delegatët e vilajeteve të tjera. Një batalion ushtarësh me në krye bandën e Shkollës së Arteve dhe të Zanateve të Shkupit u soll me shpejtësi për të pritur delegatët. Një turmë e madhe gjendej jashtë qytetit, një orë largësi prej tij, një manifestim i madh u bë për të nderuar delegacionin tonë. Brohoritjet altemoheshin me "Urra", banda ekzekutonte këngë patriotike: gjithçka të linte përshtypje të pashlyeshme. ...Pritëm mbërritjen e të gjitha delegacioneve që të hynim së bashku në qytet. Hyrja në qytetin e Dibrës është triumfuese dhe e paharrueshme. As në Selanik nuk shohim një entuziazëm të tillë, të shoqëruar nga një gëzim i papërshkrueshëm. Ishin vërtet caste prekëse. Prej syve tona zbritën lot gëzimi. Komisioni i ngarkuar për pritjen i kishte marrë të gjitha masat për bujtjen e denjë të delegatëve; çdo njeri nga dha paria u dha mikpritje tre delegatëve. Ajo që mikpritje princërore, mbretërore, me të vërtetë lindore. Dibranët deshën të bënin çdo gjë të mirë dhe ia arritën. E thënë troç, ne nuk mendonim të gjenim në Dibër një mirëqenie kaq të madhe, madje edhe enët e kuzhinës i kishin të zgjedhura; gjithçka ishte e persosur dhe zotërinjtë e shtëpive ku ne bujtëm na lanë mjaft borxhlinj.

E premte, 10/23 korrik

Në orën tre allaturka të gjithë delegatët shkuan në grupe në konak, ku do të kryhej ceremonia zyrtare për të kremtuar përvjetorin e rivendosjes së kushtetutës. Oborri i konakut, megjithëse mjaft i madh, ishte i pamjaftueshëm për të mbajtur këtë mori të jashtëzakonshme njerëzish që shtyhej. Në çastin kur hyri në oborr delegacioni i Selanikut, ndodhi një lëvizje e madhe. Myftiu i Dibrës ndërpreu për një cast lutjen solemne që po recitonte. Një trazirë e madhe ndodhi rreth tij. Çfarë do të thoshte kjo lëvizje e befasishme? Kush kishte mbërritur? Ishte, përkundrazi, Ismail Beu, deputeti i Dibrës, i goditur nga apopleksia, kishte rënë pa jetë dhe të gjithë vërtitëshin rreth tij. Festa ishte në rrezik që të prishej, por myftiu i Durrësit, një klerik i shquar për inteligjencë, ngri-ti zërin dhe tha: "Patriotët e mi të dashur, kur një gjeneral bie në fushën e betejës, ushtria a duhet të tërhiqet?! Jo! Dhe ai i yni, Ismail Beu, ndërroi jetë në mes të festes kombëtare: a duhet të ndërpritet për këtë, ceremonia? Të gjithë të pranishmit u përgjigjën njëzëri: Jo! Myftiu i Dibrës vijoi lutjen e tij të ndërprerë dhe ndërkaq kufoma u transportua në shtëpinë e tij.

Kongresi duhej të hapej po atë ditë, por vdekja e Ismail Beut, u bë shkak që çelja e Kongresit të lihej për ditën tjetër, kështu që i gjithë populli mori pjesë në funeralet e deputetit të Dibrës që u bënë madhështore.

E shtunë, 11/24 korrik

Të nesërmen, të shtunën, të gjithë delegacionet shkuan paradite në rrethin ushtarak. Atje u dha një pritje për delegatët. Delegatët e Kongresit hasën në vështirësi qysh në fillim. Ata ishin 315. Nëse diskutimi do të zhvillohej nga të gjithë, nuk do të mjaftonte një muaj i tërë për të kryer punimet e këtij Kongresi. Për ta shmangur këtë vështirësi dhe për të

Kongresi i Dibres ishte një Kongres Kombëtar Shqiptar dhe këtë e tregon edhe pjesë-marrja e gjerë e atdhetarëve shqiptarë, të cilët na i numron "Historia e popullit shqiptar", ku lexojmë: "Vehbi Efendi Dibra, Sotir Peçi, Fehmi Zavalani, Dervish Hima, Loni Logori, Hafiz Au Korça, Liam-bi Kota, Abdyl Ypi, Aqif pashë Elbasani, Benjamin Nosi, Andrea Ballamaci, Qazim Beu, Isuf Karahasani, Haxhi Ibrahim Efendiu, Murat Aga, etj,

kryer veprime të arsyeshme, propozuam të caktonim tetë përfaqësues për çdo vilajet, të cilët do të diskutonin midis tyre programin politik shqiptar dhe do të gjenin zgjidhjet për të cilat, çdo grup do të binte dakord me mandatusit e tij. Ky propozim u pranua nga të gjithë. Emrimet u bënë, të zgjedhurit u takuan atë pasdite në rrethin ushtarak, të caktuar si lokal të mbledhjes së Kongresit. Të zgjedhurit duhej të ishin 48, por nga 6 vilajete të së ashtuquajturës Turqi Europiane vetëm pesë, dmth Selaniku, Kosova, Manastiri, Shkodra dhe Janina kishin nisur delegatët e tyre, ndërsa Adrianopola (Edrene) kishte abstenuar.

Fati, që është mësuesi i çdo gjëje më futi në ata 8 delegatë që do të përfaqësonin vilajetin e Selanikut. Me këtë cilësi, munda të ndjek të gjitha debatet e Kongresit, për të cilat kam përshtypjet me të mira përse i përket racës shqiptare. Kjo race, më duket, është e destinuar të përfaqësojë një pjesë mjaft të rëndësishme në fatet e këtij vendi (Perandorisë Osmane) sepse ajo ka burime njerëzore që nuk i ndesh në racat e tjera. Unë marr me vete një hidhërim të thellë nga Kongresi i Dibrës, sepse unë nuk pashë akoma në të ashtuquajturën Turqi Europiane që të jetë adoptuar mësimi i stenografisë. Nëse do të ishin stenografuar të gjitha bisedat e mbajtura në këtë Kongres, nëse do të mund të përcilleshin me shkrim të gjitha propozimet, shkëmbimet e bisedimeve në zjarin e bisedimeve, do të ishin mbledhur dokumenta me një vlerë të paçmueshme për arkivin e vetë Kongresit." (La nazione albanese, 15 gusht, 1909)

Nga diskutimet e mbledhjes së tretë Nga diskutimet në mbledhjen e tretë në Kongresin e Dibrës shohim se si trajtohet çështja e shkollave shqipe dhe e alfabetit të saj. Delegati i këtij kongresi, Qenan Manastiri, në librin e tij "Kongresi i Dibrës" na bën të ditur se në këtë mbledhje Hafiz Ali Korça kërkoi hapjen e shkollave shqipe, por ai u kundërshtua nga Sybi Efendiu që thosh: "Me çfare shkronja do të shkruhet shqipja? Duhet theksuar se ana e Gegërisë shkronjat latinisht nuk i pranon." Ndërsa shoku i tij Riza Beu pohonte: "Gjuha kombëtare, dmth shqipja, nuk ka nevojë të mësohet. Neve turqishtja na mjafton. Në shkollat vetëm turqishtja lexohet."

Në këtë mbledhje grupi xhonturk pati kundër shumicën dermuee të delegatëve të Kongresit. Ata hodhën poshtë kërkesat antikombëtare të tyre. Patrioti Qenan Manastiri kërkoi çeljen e shkollave shqipe, kurse... "çështja e shkronjave — pohoi ai — mbetet në dëshirën e shqiptarëve." Për kohën, ky vendim ishte i drejtë, sepse të tilla ishin mundësitë në Shqipëri. Është për të vënë në dukje se një vit më vonë, 14 deputetë të parlamentit osman që përfaqësonin një pjesë të mirë të popullit tonë, kërkuan nga veziri Haki Pasha që për shkrimin e shqipes të përdorej alfabeti arab dhe të ndalohej alfabeti latin; pastaj të mos harrojmë se edhe në Kongresin e Dytë të Manastirit u vendos që në Shkup të themelohej një gazetë e re në shqip dhe turqisht. Po ashtu edhe në promemorjen prej katër pikash që u dergua Portës

së Lartë, u kërkua midis të tjerash, "T'u lihej mësuesve shqiptarë e drejta e zgjedhjes së alfabetit të shqipes, siç që vendosur në Kongresin e Dibrës."

Në këtë rast vlen të kujtohet neni 4 i Kushtetutës xhonturke të cilët iu bë një amendament, ku midis të tjerash theksohej se të gjitha klubet a shoqëritë politike në emër vetëm të një kombi janë të ndaluara.

Duhet theksuar se në Kongres mbizotëronin dy rryma. Riza Beu ringuli këmbë që të mos mësohet shqipja duke thënë, "Kur të mësohet turqishtja. Ç'duhet shqipja!?", ndërsa Qenan Manastiri, iu përgjigj, "Sikur të hapen në çdo katund shkolla turke, vetëm turqisht të mësohet, por pa shkruar njëqind vjet dhe pa kaluar tre breza nuk mund të arrihet ajo që thotë Riza Beu, sepse gjatë një kohe të atillë, me anë të përparimeve që do të bëhen në fushën e arsimit, shqiptaret humbasin e shkojnë. Por atëherë, Zoti mos e dhëntë, edhe osmanët mundet që nga Europa të fluturojnë e të shkojnë!"

Theksojmë se kjo ironi therrëse e përdorur në Kongresin e Dibrës kundër xhonturqve me teorinë e tyre të osmanizimit te popullsisë së Perandorisë Osmane dhe botuar në Stamboll në kohën e sundimit të turqve te rinj, tregon edhe një herë se sa e fortë dhe dominante ishte rryma antixhonturke në Kongresin e Dibrës.

Të bën përshtypje qëndrimi antikombëtar i Riza Beut. Ai u drejtohet bajraktarëve të Shkodrës duke iu thënë: "A nuk është e vërtetë që ne nuk e duam gjuhën shqipe në shkollat tona?"

Abdyl Ypi (me entuziazëm) "Oh, o Zot, gjuha e mëmës, fjalët e babës, nuk duhet të përbuzen. Ne që nuk na ka hije një gjuhë tjetër, gjuhën tonë nuk e duam?! Fjala e parë një fëmijë që pi qumësht, kënga e parë e atij bilbililit të natyrës të mos dëgjohet?! Zotërinj, thelbi nuk ndryshohet, njeriu në esencë është ai që është. Ne ishim shqiptarë, shqiptarë jemi dhe shqiptarë do të mbetemi dhe gjuhën tone do ta përparojmë."

Seit Aga "Gjuhën tonë medoemos do ta lexojmë."

Murat Agë Gjakova, "Shqip patjetër do të lexojmë."

Isuf Beu nga paria e maleve, "Nga gjuha jonë nuk heqim dorë, atë do të lexojmë."

Halim Beu, "Shqip do të lexojmë, po për çështjen e shkronjave të vihet një kusht."

Qenan Manastiri, "Ju lutem, çështjen e shkronjave të mos e zemë në gojë, se mbase kundërshtimi që qëndron në këtë pikë shkaktonte ngatërrime të rëndësishme. Atë t'ia lemë kohës ta zgjidhë." Qenan Manastiri, Kongresi i Dibrës, Stamboll 1912.

Dhe kështu u bë, koha e zgjidhjes së kësaj çështje. Për këtë çështje, vijojmë me delegatin Selanikut, të cilin po e citojmë nga "Journal de Salonique": "Dueli oratorik ishte shumë i bukur dhe, kur u kalua në votim, u zbatua metoda e Solomonit: dardha u nda në dysh. Parimi themelor ishte që liria duhet të sundojë mbi gjithçka, me kusht që të gjitha veprimet të kenë vlerë e realitetit. U vendos që secili mund të adaptonte shkronjat që dëshironte, duke lënë të tjerët krejtësisht të lirë të përdorin të tjerat shkronja, nëse e tillë ishte bindja e tyre. Për çështje të atij lloji, duke mos pasur zgjidhje përfundimtare, pa miratimin e kohës, u vendos që t'ia lejonin të ardhmes të caktojë zgjedhje me të drejtë midis përkrahësve të alfabetit arab dhe atij latin. Kjo ka qenë zgjidhja më e drejtë, prandaj me duartkitje unanime u prit rezultati i votimit". La nazione albanese, vep. e cit.

Komentet se cilat shkronja janë më të përshtatshme i bën shtypi i asaj kohe, citojmë njërin prej tyre, Feim Zavalanin: "Shkronjat latine janë fort të lehta, shkronjat arabe janë fort të rënda. Sa mund të bëhen gurët bukë dhe në kopësht të mbijë kripë aq mund të shkruhet me shkronja arabe gjuha jonë shkronjat tona janë si hekurudhat, ne nuk duam te ecim me gamile". "Bashkimi i kombit", nr. 20, 9 nëntor 1909.

LAJME

nga shtypi i përditshëm

MUNGESA E MEDIKAMENTEVE FAVORIZON EPIDEMINË GRIPALE

Viroza gripale, siç deklarojnë vetë mjekët, në rajonin e Dibrës, është kthyer në një epidemi gripale të vërtetë, me raste që vijnë gjithmonë e më shumë në rritje dhe me komplikacione të rënda për shëndetin e banorëve, sidomos për fëmijët dhe të moshuarit. Në rritjen e numrit të pacientëve të prekur nga viroza gripale, thonë mjekët në spitalin e qytetit të Peshkopisë, ka influencuar dukshëm edhe mungesa e vaksinës antigrip, në farmacitë e këtij qyteti. Madje, kjo mungesë vërehet në të gjitha farmacitë e Qarkut të Dibrës dhe mbarë vendit, vijojnë në fjalën e tyre, këta mjekë.

Në lidhje me këtë, farmacistë të shumtë, në qytetet Peshkopi, Bulqizë dhe Burrel, deklaruan se disponojnë në sasi të konsiderueshme vaksinash antigrip, madje të mbetura stok nëpër magazina, por nuk disponojnë vaksinën e duhur për virozën aktuale të gripit tepër të rrezikshëm, nga i cili janë prekur banorët, raste këto, që çdo ditë e më tepër vijnë në rritje. Mjeku pediatër me eksperiencë të gjatë pune, Hasan Lleshi, fajëson direkt shtetin, për mungesën aktuale të vaksinës antigrip. Është Instituti i Higjienës dhe Epidemiologjisë në Tiranë, thotë ai, që duhet të përcaktojë llojin e virusit të këtij gripi, gjë që ende nuk është bërë edhe pse situata gripale ka mbërthyer mbarë vendin prej muajsh të tërë. Në të tilla kushte, kur mungon vakcina efikase për të luftuar virozën aktuale gripale, mjekët nuk kanë se çfarë t'u rekomandojnë pacientëve të tyre të shumtë, për t'u mbrojtur nga kjo virozë gripale. Gjithsesi, kjo vonesë e pajustificueshme, në përcaktimin e virozës gripale, që qarkullon prej muajsh në vendin tonë, është një akuzë e hapur për Ministrinë e Shëndetësisë dhe strukturat vartëse të saj. (SHQIP)



TREGU NË RRUGË, KONSUMATORËT TË PA MBROJTUR

Në të gjitha zonat urbane të Qarkut të Dibrës, si Peshkopi, Maçellarë, Shupenzë, Bulqizë, Klos dhe Burrel, tregu e zhvillon aktivitetin e tij në rrugë, midis pluhurit e baltës së shiut. Në asnjë prej këtyre zonave tregu nuk është i sistemuar konform standardeve të lejuara për mirëfunksionimin e tij. Të mos harrojmë se në këto tregje ka një gamë shumë të madhe artikujsh që tregtohen si: mish, bulmetra që vijnë nga fshatrat rreth këtyre tregjeve, fruta, perime, kinkaleri, veshmbathje, bare, enë llamarine, këpucë e roba të vjetra e deri lavazhe makinash. Natyrisht artikujt ushqimorë zënë edhe peshën kryesore në mbushjen e këtyre tregjeve, si dhe përbëjnë mundësinë më të madhe për rrezikimin e shëndetit të konsumatorëve. Themi kështu, pasi në këto tregje çdo gjë lëviz në mënyrë kaotike dhe të çrregullt. Në shumë nga këto qytete ata janë të vendosur spontanisht nga tregtarët në trotuarët e bulevardëve, ku ndër të tjera vështirësojnë mjaft lëvizjen e lirë të qytetarëve. Gjatë gjithë ditës pluhuri që shkaktohet nga lëvizja e madhe e makinave bie mbi artikujt ushqimorë të këtyre tregjeve, duke i kthyer në një rrezik permanent për shëndetin e konsumatorëve. Tradicionalisht këto tregje kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë jashtë çdo kontrolli, si nga organet higjieno-sanitare të shëndetësisë, ashtu edhe nga inspektoratet e ushqimit pranë drejtorive të bujqësisë dhe ushqimit në rrethet respektive: Dibër, Bulqizë dhe Mat. (SHQIP)

DIBËR, 20 POLICË PADISIN AUDITIN E MINISTRISË

Auditi i Ministrisë së Brendshme, gjatë një kontrolli të zhvilluar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Dibër, ka ndëshkuar për përfitime të padrejta pothuajse të gjithë efektivat e kësaj policie. Kontrolli është shtrirë për një periudhë kohore 4-vjeçare, 2002-2006. Burime nga kjo drejtori saktësuan për "Shqip" se vlera financiare e këtyre ndëshkimeve shkon nga 1000-150000 lekë të reja. Po sipas këtyre burimeve, janë efektivat blu të ndëshkuar me gjoba më të rënda, ata që kanë kontestuar këto ndëshkime, që sipas tyre janë të padrejta. Gjobat e vëna për efektivat e policisë në tre komisariatet Dibër, Bulqizë dhe Peshkopi, janë motivuar nga kontrolli i Auditit të Ministrisë së Brendshme, si përfitime të padrejta nga ata, për tejkalime limitesh në paga, dieta, dru zjarri, karburante, orë jashtë orarit të punës etj. Deri më tani janë 20 efektiva të kësaj policie, që kanë paditur në gjykatat e shkallës së parë të këtij qarku Auditin e Ministrisë së Brendshme për gjobat e vëna, që sipas tyre janë të padrejta. Burime nga këto gjykata konfirmojnë se numri i policëve që kanë paditur Ministrinë e Brendshme është rritur në mënyrë të dukshme, pasi padive për pushime nga puna për shkak të reformës në polici u shtohen edhe këto të 20 policëve. (SHQIP)

Nga Prof. Dr. SHABAN SINANI

Në gjithë hartën folklorike të Shqipërisë është pothuajse e pamundur të gjejmë një vend, një zonë etnografike, ku kënga të jetë e ndarë nga dasmat, të ketë një jetë më vete e të pavarur prej tyre. Në kuptimin e plotë të fjalës, në krejt truallin shqiptar, dasmat kanë qenë festa të artit, të këngës, forma më e organizuar e veprimtarisë kulturore të popullit; ato kanë qenë njëherësh festival krejt i natyrshëm i zërave dhe këngëve të reja, provë gjenerale e tyre, momenti më i rëndësishëm i kontakteve intensive të njerëzve më vlerat shpirtërore të trashëguara nga parardhësit e të krijuara nga ata vetë.

Kënga e re që pëlqehet në dasmë, merrte miratim për t'u përhapur, ajo fitonte pasaportën e fitueses dhe nënshkrimin e poetit anonim popullor. Ky ishte nderimi më i madh dhe vlerësimi më i lartë për krijimtarinë, Firma e anonimit popullor nuk vihet në çfarëdo arti. Vetëm krijimtaria e klasit të parë e meriton atë.

Sot kënga popullore, sidomos ajo e dasmës, është zhveshur e lehtësuar nga disa funksione, për të cilat, tashmë, janë krijuar mjete specifike. Dikur ajo nuk ka qenë thjesht art, argëtim, por dhe nxitje, dekoratë (siç e quan Kadareja), nderim, manifest i mendimit dhe shijeve popullore. Ajo sillte kënaqësi shpirtërore jo thjesht me vlerat estetike, por dhe me funksionarët e tjera joartistike të saj. Kjo vihet re veçanërisht me këngët folklorike të dasmës dibrane, sidomos të asaj të zonës së Reçit e Dardhës, në të cilat dallohet ndoshta më shumë se në disa treve të tjera folklorike, dhe një rol krejt specifik: këngët e dasmës janë dhe organizatore të ceremonisë, pjesa më e rëndësishme e saj, komponenti urdhërues i saj.

Është e qartë që, edhe në dasmën dibrane, kënga popullore nuk ekzekutohet thjesht për të organizuar e disiplinuar ceremoninë dhe njerëzit që e realizojnë atë. Ajo, mbi të gjitha, nevojitet për të krijuar atë atmosferë të ndezur festive e gazmore, pa të cilën dasma nuk do të ishte e tillë. Njerëzit në dasmë këndojnë për të shprehur gëzimin e tyre, dhe, me këtë rast, ua lehtësojnë punën organizatorëve, duke drejtuar nëpërmjet këngëve urdhra, thirrje, lajme e falenderime, duke shprehur nëpërmjet tyre gjendje e qëndrime emocionale ndaj të ftuarve, ndaj akteve të ceremonisë, ndaj realizuesve të saj.

Në kuptimin figurativ të fjalës, shumë këngë dibrane të dasmës janë "këngë që japin urdhër", që drejtojnë tërë veprimet e dasmës, rregullatorë të ritualit kryesor të jetës njerëzore. Nuk janë të pakta ato krahu etnografike ku arti ka pasur dhe ka një pushtet të tillë të plotfuqishëm, jo vetëm me forcën shprehëse, por edhe me rolin organizativ, jo vetëm mbi njerëzit, por edhe mbi vetë ceremonialin. Por ajo që kërkon kënga e dasmës dibrane duhet të kryhet pa diskutim dhe në çast, në sytë e këngëtarit popullor, sa pa mbaruar ekzekutimi i saj. Duket se kënga ka konservuar një gjendje tepër të lashtë të artit popullor, gjendjen kur ai nuk ishte ndarë ende krejtësisht nga rituali dhe ishte veprimtari e shoqëruar e tij.

Në dasmën dibrane është krejt e zakonshme që kënga të shoqërohet me një veprim, me një rit, me një akt të ceremonisë, ose anasjelltas. Përkundrazi, me shumë vështirësi mund të gjejmë atilla që nuk kërkojnë veprim, këngë, si të thuash, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, vetëm në funksione artistike, këngë që nuk urdhërojnë të ekzekutohet ky apo ai rit, këngë të çliuara nga ai funksion. Jo se këngë të tilla mungojnë, kjo do të ishte njëanshmëri e dobësi e artit gojor të këtyre zonave. Këngët lirike të dasmës, ashtu si dhe ato epike të trimërisë, nuk mungojnë, bile janë të shumëllojshme e të larmishme. Ajo që mungon brenda ditëve të



Rreth kodit artistik të dasmës dibrane

dasmës, aq e ngarkuar me ngjarje e episode, është koha. Dasma dibrane, që nga çasti i fillimit, është e mbushur me ceremoni e rite. Janë pikërisht këta komponentë etnografikë të dasmës, që, duke kërkuar këngën e vet, nuk të lënë shumë kohë të marrësh frymë, të merresh me këngët thjesht lirike. Duke u nisur nga fakti që kënga e dasmës dibrane kryen edhe të tilla shërbime joartistike, mund të pohojmë se ajo është e veçantë e polivalente. Sigurisht, ajo është vetëm njëra prej shfaqjeve të karakterit shumëfunksionësh e sinkretik të artit popullor shqiptar.

Sikur edhe me një shikim të sipërfaqshëm të vëzhgosh dasmën dibrane, të bie menjëherë në sy simbioza e artit me elementin etnografik, e këngës me zakonet, shkrija në të e vlerave krijuese me shërbimet e tjera. Dasma dibrane, bie fjala, nuk mund të konsiderohet e hapur, pa u kënduar publikisht kënga e krijuar tamam për të lajmëruar këtë moment:

O moj lulja e frashnit t'bardhë,
Kur e ke ndërmend me ardhë...

Më bukur e më natyrshëm s'ka si hapet kjo ceremoni. Asnjë korrier, asnjë lajmëtar, nuk mund të shpërndajë më bukur e më njerëzishëm se kënga njoftimin e ftesën njëherësh për dasmë.

Bashkëjetesa e këngës me ritin në ceremonialin dibrane të dasmës është aq e spikatur, sa është zor të thuash në ka lindur e para të dytën apo anasjelltas. Si rregull nuk ka asnjë element me të vërtetë të qendrueshëm të ceremonisë, të cilit të mos i përgjigjet kënga e vet. Zakonisht kënga prezanton ritin dhe ky thërret në moment këngën. Kjo është arsyeja që kënga dibrane e dasmës këndohet vetëm në një moment të saj. Këngëtarit popullor nuk e ka në dorë ta këndojë në çdo kohë këtë apo atë këngë. Gjithçka është e paracaktuar nga rregullat e trashëguara së lashti. Kodi i ceremonisë së dasmës nuk i lë jashtë disiplinën as këngët. Në pamje të pare, duke marrë me vete këngët, dasma e këtyre zonave ngjan si një program artistik që është përsëritur dhjetëra e dhjetëra herë, aq sa tashmë dihet përmendësh renditja e pjesëve, me ndryshimin e vetëm që ky spektakël nuk bëhet kurrë i bezdisur. Ekzekutimi i këngës jo në momentin e kërkuar jo vetëm do t'u binte ndesh rregullave të pëlqyer nga brezat, por do të shkaktonte dhe situatë humorit, habi e çoroditje.

Të lidhura bashkë, po të shiheshin

në unitet, këngët dibrane të dasmës i ngjajnë një operete të një lloji të veçantë. Natyrisht, ato nuk kanë të përbashkët me këtë gjini muzikore as stilin, as mënyrën e organizimit, as strukturën, as shkallën e ndërlikimit. Ngjashmëria që bie në sy është e pjesshme. Edhe në këngët e dasmës dibrane, ashtu si dhe një operetë, ana muzikore shoqërohet me veprim dramatik. Le ta ilustrojmë me një detaj nga dasma: Njerëzit dashamirës që mbledhen çdo mbrëmje në shtëpinë e të zotit të dasmës që një javë më parë mikpritësi nuk i fton me fjalë, por nëpërmjet këngës popullore që ekzekutohet kur mysafirët natën vonë kthehen në shtëpitë e tyre. Ja situata me një pamje më vizuale: Në çastet kur miqtë kanë dalë në oborr dhe ndahen me njëri-tjetrin, një grup këngëtarësh këndojnë:

Ky tabaku me filxhana,
Të gjith' t'vini nesër mbrama,
Të gjith' t'bani natën e mirë.

Kënga e çliron të zotin e shtëpisë nga detyra për t'iu drejtuar të gjithëve një për një të vijë përsëri të nesërmen, duke e kryer mjaft më ëmbëlsisht se ai këtë grishje përmes këngës. Krahasimi këngës së dasmës dibrane me artin modern operistik, megjithatë, ka një hallkë ku çalon. Nëse në një operetë klasike këngëtarit dhe aktori janë një, në ceremonialin e dasmës dibrane këto funksione janë të ndarë: të jërë këndojnë, të tjerë veprojnë. Me një fjalë këngëtarit popullor i fton të tjerët të veprojnë, të lëvizin, të plotësojnë ato kërkesa që ka ceremonia, por vetë këndojnë të jashtëm. Ka momente kur duket sikur këngëtarit popullor nuk ka tjetër qëllim vetëm të përshkruajë me art atë që ndodh para syve të tij, të ftojë pjesmarrësit të jenë të pranishëm në ngjarje.

Që këngët shoqërojnë, paraqesin apo urdhërojnë kryerjen e veprimeve të ceremonisë, kjo është shenjë e sigurte lashtësie të padiskutueshme. Lidhja organike e këngës me veprimin dramatik, e artit me ritin, reflekton mentalitetin e stërmoçëm të atij stadi të njerëzimit primitiv, kur këto dy veprimtari ende nuk ishin ndarë e diferencuar. Arti, siç pohojnë shumica e studiuesve të historisë së tij, në fillim ka qenë pjesë e pandarë e ceremonive jetësore dhe në shërbim të tyre (njerëzit e parë nuk niseshin për gjah "pa e vlarë" më parë në një vizatim mbi tokë atë pa i kënduar rreth e qark atij

me lutje e rite).

Sido që ka edhe ndonjë situatë kur këngëtarit vepron vetë dhe i plotëson aty për aty kërkesat e këngës; sido që ka edhe raste kur këto dy role janë bashkë tek ekzekutuesi i saj, kjo nuk është kryesorja. Më e rëndësishmja, cilësi që e dallon këngën dibrane, është roli i saj si art e si strukturë e ritualit. Në dasmën dibrane, si dhe gjetiu, ka një organizator, një kryetar, një drejtues, por, në dallim nga zona të tjera, në këto anë ai është me kompetenca më të kufizuara. Urdhërat më të rëndësishëm i jep kënga. Krushqit, ta zëmë, nuk mund të nisën pa u kunduar "urdhëri" i tyre:

Udhë e mbarë o krushku i pare
M'i thuaj lules a je t'u ardhë...

E njëjta lidhje ekziston edhe për hallka të tjera të ceremonisë. Flijimet e dasmës theren kur këndohet kënga përkatëse, dita e druve çelet gjithashtu me një këngë thirrje, ku me humor nxiten njerëzit e afërm të të zotit të shtëpisë të bëjnë punë e shërbime. Pak a shumë kënga merr kështu funksionin e lajmëtarit. Kjo është kaq e vërtetë sa në dasmën dibrane, në ditët e ardhjes së miqve, caktoheshin njerëz posaçërisht me punën e vrojtuesit, me qëllim që asnjë mysafir të mos hynte brenda pa iu kënduar kënga. Po të ndodhte e kundërta, kjo do të ishte një fyerje e pandreqshme për të ftuarin.

Kaq e rëndësishme ishte të këndohej kënga, sa, në mungesë të saj, në raste të rralla, ka ngjarë që motra e dhëndërit të lërë dasmën e të largohet, e tronditur nga mungesa e vëmendjes dhe e vlerësimit, dhe episode të tjera të pakënaqshme. Në një farë kuptimi, njerëzit mezi prisnin t'u vinte rasti që t'u këndohej kënga, të barazoheshin me të shquarit, të hynin në kronikë, veçse ky rast ishte shumë i kursyer. Dhe kur vinte ky rast askush nuk e duronte që t'ia hiqnin të drejtën për të hyrë në këngë, sepse, goftë edhe për një rast, goftë edhe për një situatë, kjo ishte një kënaqësi e veçantë.

Duke qenë një këngë urdhëruese, kënga dibrane e dasmës, megjithatë, nuk është aspak e ashpër, e thatë, por, përkundrazi, është e mbushur me ngrohtësi e lirizëm. Ajo është e aftë të krijojë emocione të mëdha dhe situata solemne, Ndonëse ka rreptësi dhe njëfarë protokollit (kur vijnë një grup të ftuarish, vetëm të parit dhe të dytë i përmendet emri, të tjerët përshëndeten bashkërisht), ajo është, prapëseprapë,

► një hapësirë e lirshme, një tribunë demokratike. Kënga dibrane e dasmës e ka përballuar me dinjitet e me plot sukses mbingarkesën që krijon normalisht funksionet e jashtme. Në gjendjen e sotme këto funksione nuk ngajnë më të tepërta mbi këngën.

Në veçanti, gjendje të ngritura emocionale krijojnë ajo që në të folmen e vendit quhet "horë", emërtim që besojmë të ketë lidhje me një nga elementët më të rëndësishëm të dramës antike greke, me korin e famshëm, siç mud të shihet edhe nga emri. Ka rëndësi që përngjasimi nuk është vetëm tek emri. Në dasmën dibrane nata e së premtes para dasmës quhet ndryshe edhe "nata e horës". Quhet kështu pse kjo është nata kur të gjithë, burra e gra, ngihen bashkërisht të këndojnë. Bile nuk mungon as korifeu. Natyrisht ai nuk quhet me këtë emër, por merr funksionet e tij. Kjo është nata e këngës kolektive. Ai që prin këngën, korifeu, le ta quajmë kështu, këndon i vetëm vargun e parë, që përsëritet nga gjithë pjesmarrësit, dhe kështu vazhdohet më tutje deri në fund të këngës. Ky paralelizëm është një tjetër dëshmi vjetërsie antike për folklorin dibrane të dasmës.

Hora, me sa duket, ka qenë jo vetëm stil të kënduari ("Hajd' t'marrim një horë / Të gjithë dorë për dorë"), por dhe mekanizëm për krijimtarinë dhe për përsosjen e artit. Një vështrim i vëmendshëm mbi dasmën dibrane të çon në përfundimin se pikërisht hora i jepte mundësi këngëtarit të krijonte, të shtonte vargje e vlerësime për personat konkretë të cilëve u këndohej, të harmonizonte të përgjithshmen me të veçantën.. Mënyra si ekzekutohet hora është mjaft e përshtatshme për këtë. Gjatë kohës që të gjithë së bashku përsërisin vargun e parë, ai që i prin horës ka kohë të krijojë e të provojë një varg të ri. Për një lidhje të mundshme etimologjike midis fjalëve "kor" e "horë" flet jo vetëm fakti që në greqishten e re tingulli x është midis h-së dhe j-së, por dhe një kuptim i ruajtur i fjalës sonë në njësinë frazeologjike "na i bëri zemrat horë" - na gëzoi pa masë, që gjendet edhe në fjalorin e shqipës së sotme.

Eshtë i njohur edhe përdorimi i fjalës horë për fshat dhe për fshatçe (Hora e arbëreshëve etj) Por ky kuptim nuk është zanafillor, ai është kuptim metaforik. Horë në fillim ka nënkuptuar bashkësinë, pastaj zëvendësoi fjalën fshat. Eshtë për t'u përmendur gjithashtu fakti që pothuajse në gjithë Shqipërinë vajtimi, që është edhe në konservator se kënga, realizohet si në korin antik: i pari thur vargun, të tjerët e përsërisin.

Siç dihet, kënga me të marrë e me të pritur është karakteristike për zonat jugore të vendit, për polifoninë labe. Nëse dhe në horën dibrane cilësi përcaktuese është ekzekutimi me të marrë e me të pritur, kjo flet për ekzistencën e një elementi të lashtë mbarëkombëtar. Ashtu si në këngën labe, edhe në horën e dasmës dibrane, dikush ia merr dhe kori, bashkësia, ia pret. Ndryshimi është vetëm në faktin që e para këndohet me polifoni.

Eshtë për t'u vënë re gjithashtu që, sa më shumë afrohet e diela e dasmës, aq më shumë e më shpesh del kënga në rol, si të thuash, disiplinues. Po të rikonstruktiohej, bie fjala, e diela pasdite, do të shihej që nuk do të mbetej thajse asnjë çast bosh, pa këngën përgjegjëse, pa vëprimin përkatës. Ja episodi, pak a shumë i plotë, duke marrë si pikënisje këngën e ardhjes së nuses: solemniteti në kulm, në këngë lavdërohen krushqit që e morën nusen pa telashe:

Raka dielli, raka hana,
Për midis të udhës,
Po na vika krushku i parë
Me nusen përmbra.

Pak dyshim, gjithçka të kujton një situatë bisedimesh kuvendi, midis krushqëve e përcjellësve, të cilët, sipas zakonisht, duke qenë se martonin vajzë, nuk duhej të shfaqeshin të hareshëm.

Njerëzit e shtëpisë venë të shohin nusen:
Ka ardhë dhandri me ta pa
Me një dorë prej temena.

Nusja nxirret të shihet nga të gjithë dasmorët. Ky është momenti ku konsumohen këngët më të bukura për hijeshinë e vajzës. (Paskë ata sy oj nuse / si hana kur bie). Solemniteti bie, pak humor, lavdërohet nusja e re në kurriz të kunatave, me të cilat "s'ka krahasim". Një kthesë e shpejtë emocionale: ngrihet lart fisi i dhëndrit dhe përshkruhet me dhimbje situata shpirtërore në shtëpinë e nuses tash që vajzën e kanë larg. (Nëna e nuses merr një dorë kashtë / kërkon brënda e kërkon jashtë /

Ku e kam vajzën t'hamë darkë bashkë). Toni humoristik shtohet, ngrihet lart dhëndri dhe qortohen bashkëmoshatarët e tij pse vonohen (Ky filani ku i la shokët / Në livadh, çobanë me lopët). Situata emocionale kthehet në krahun tjetër: dhëndri ndahet nga njerëzit e shtëpisë për t'u bashkuar me nusen dhe tërë ky akt shoqërohet me këngë prekëse (Hajt ta lidhim besën-o / ku jemi bashkë / a do ta duash nanën-o / sikur e ke dashtë). Këngët, si të thuash me protokolll, mbyllen me disa pjesë që i këndohen nuses (Mos ma shtrëngo krahi / As kujton gjynahin / Zogu i dadës-o / Ylli i natës-o). Më tutje mund të këndohet çdo lloj kënge, por tashmë ka kaluar mesi i natës. Asgjë jashtë kontrollit të këngës, deri në këtë çast. Gjithçka e urdhëruar prej saj.

Eshtë e vështirë të merret më mend ç'konfuzion do të shkaktohej sikur për një çast të prishej radha e këngëve apo të ndërpritej ekzekutimi i tyre. Të mendojmë se është ditë e hënë, mëngjes. Sipas rregullit, të hënë dasmorët shpërndahen. Mirëpo para se ata të kërkojnë leje për të ikur, duhet të këndohet kënga që i përgjigjet këtij momenti. Nëse kjo, supozojmë, nuk ndihet, po vonohet, dasmorët nuk shpërndahen, sepse kjo konsiderohet si ftesë e të zotit të shtëpisë për të vazhduar gëzimin. Në të kundërtën, në rast se kënga do të ekzekutohej të dielën pasdite, të ftuarit do të iknin para kohe, natyrisht qejfprishur, ndonëse të lutur nga i zoti i shtëpisë për të falur për keqkuptimin.

Le ta shohim edhe në një situatë tjetër se ç'amulli do të sillte ekzekutimi i këngës jo në kohën dhe në vendin e vet. Para se të shpërndahen dasmorët, të hënë në mëngjes, sipas radhës, këndohej kënga e akcijnive (kuzhinierëve), në të cilën qortohej në ton shakaje i zoti i dasmës pse nuk bëri aq shpenzime sa duheshin për t'i kënaqur më mirë të ftuarit. Nëse kjo këngë do të këndohej të premtën, pasojat do të ishin krejt të kundërta: ajo do të quhej urdhër për të shtuar e dyfishuar bagëtisë e therurara dhe shpenzimet e tjera. Veç të tjerash kjo do të ishte një ofendim për të zotin e shtëpisë, të cilit, dashje pa dashje, i bëhej qortim për mungesë bujarie.

Eshtë pikërisht kjo specifikë e këngës që përbën edhe thelbin e specifikës së vetë dasmës dibrane. Kjo merr formën e një spektakli rigoroz, sa të larmishëm, aq dhe të disiplinuar. Rregulli dhe harmonia që sundojnë në dasmën dibrane, me gjithë grumbullimin e madh të njerëzve, zakonisht shkak konfuzioni e të papriturash, i dedikohen në radhë të parë artit. Kjo është gjithashtu shprehje një lashtësie të thellë. Veçanërisht që fakti që ngjyrimi fetar në këtë art është gati si një palimpsest, shtresë mbi shtresë, flet për një jetë shumëshekullore të tij.

Kënga dibrane e dasmës është një harmonizim i përsosur i funksionit artistik me atë organizativ të saj. Poeti popullor nuk kalë në asnjë moment të dasmës dhe asnjë protagonist të saj pa këngën e vet. Le ta ilustrojmë këtë me këngën e mëngjesit të së hënës para se dasmorët të jenë ngritur nga gjumi. Kënga këndohet në emër të nënës së dhëndrit:

Duel drita, po këndojnë gjelat
Çile nuse, derën
Çile derën, qitma djalin
Muer nana malin.
Përgjigja është:
Ma ka zan' ashikun gjumi,
Ma ka zan' krahin përfundi
S'mund t' ta çeli derën.

Dasmat, në kuptimin e plotë të fjalës, kanë qenë jetuar me intensitetin e një kohe jo të zakonshme. Ata krijojnë një stil të veçantë marrëdhëniesh e raportesh midis njerëzve. Jo vetëm në art por gjatë tërë ditëve të dasmës, gruaja, bie fjala, gëzonte një liri pa krahasim më të madhe se në ditë të zakonshme. Ajo që për të në kohë tjetër ishte ëndërr, gjatë dasmës prekej e realizohej. Dhe ishte pikërisht kënga çelësi i këtyre marrëdhënieve, natyrisht më të lirshme e më të ngarkuara me emocione.

Edhe një tipar tjetër i këngës së dasmës dibrane duhet vënë re. Kjo këngë është a e pasur në ngjyrim, motive, tone e ngarkesa të tjera emotive, sa mund të pohohet pa frikë se i përgjigjet plotësisht gjithanshërisë së jetës. Kjo këngë ka edhe solemnitet, edhe lirizëm të ngrohtë, edhe paralajmërim të rrepta, edhe humor, edhe momente dramatike, edhe çaste dëfrimi. Ky kompletim e bën atë të mos ndihet kurrë e tepër dhe, në të kundërtën, të mos mungojë në asnjë moment që është e nevojshme.

BOTIME TË REJA

"Një iluminist i etur për dituri"

Pak fjalë
rreth
librit me
kujtime,
të Hasan
Lekës



Nga HAJRI MANDRI

Në librin e tij, intelektuali i mirënjohur Hasan Leka ka dhënë një pasqyrë të gjallë të një individi që na kalon nga fshati në qytet, nga varfëria tek jeta në qendër të kryeqytetit, nga injoranca skolastike në një fshat të thellë dibrane, tek rektorati dhe bota akademike, nga fëmijëria që përbën thelbin e filozofisë pragmatiste të tij. Midis idealit të frymëzuar dhe njeriut të zhgënjyer në tranzicion, nga oferta e tij si njeri me integritet të lartë moral tek kërkesa e realitetit shoqëror të çekuilibruar nga tranzicioni, qëndron Hasan Leka, i cili për nga dendësia e aktivitetit të tij, përbën një personazh interesant dhe me vlera për nga logjika dhe morali që e ka udhëhequr në jetë. Mjaft ngjarje dhe personazhe të tjerë plotësojnë figurën e heroit kryesor të librit me të cilët ai është i lidhur me një mijë fije të dukshme dhe të padukshme interesash shpirtërore, kulturore, materiale e jetësore. Libri përbën një vepër që sjell mjaft informacion e që përshkruan në mënyrë analitike dhe sintetike situata psikomurale mjaft të goditura që të tërheqin për t'i lexuar. Ai pasqyron me realizëm ng-

jarje të kohës.

Si një personazh tipik, në rrethana tipike, Hasani na çon në mjedise pune interesante për këdo, dhe nga vetë përvoja e tij ai ka nxjerrë nga jeta mjaft konkluzione që përbëjnë një vlerë dhe një përvojë që u shërben edhe të tjerëve. Protagonisti i këtij libri është një iluminist i etur për dituri dhe këtë etje e tregon në përpjekjet e tij vigane për të ndriçuar mendjen dhe për të pasuruar dijen duke e përcaktuar si kredon dhe rrugën e tij më të dobishme, ai është një humanist i thellë kur paraqet marrëdhëniet e tij me njerëzit e familjes dhe të gjakut. Në mjaft episode ai është prekës në raportet sensibël me vëllezër dhe motra, me gruan dhe fëmijët. Autori me figurën e tij në jetë është një model edukues për shoqërinë, pasi ai mbështetet në skrupuj moralë dhe të pandryshueshëm. Gjuha në libër është e thjeshtë me një leksik shqiptar të ëmbël, me fraza të punuara me mjeshtrëri, e cila rrjedh natyrshëm pa sforçime, gjë që tregon kulturën e lartë gjuhësore të autorit. Gjykimet e tij mbi realitetin mbeten kryesisht në planin subjektiv dhe lidhen me rrethanat që kanë imponuar motivet dhe qëndrimet e autorit në situata të caktuara vendore dhe kohore. Autori ka botuar edhe libra të tjerë dhe dëshirojmë që ta vazhdojë punën e tij krijuese. I urojmë autorit suksese dhe jetë të begatë!

